

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime

2012



Publikuar nga
Enti Rregullator i Ujit i Shqiperise (ERRU)
Blv. Gjergj Fishta, Nr.10
Tirane, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel.: 00355 4 2258046
Faqja e internetit: www.erru.al

© Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Shtator 2013

ISSN: 2305-3445



Implemented by



Printimi i këtij publikimi u mbështet nga

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Programi për Reformën e Ujit, Shqipëri

Vizioni

Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Misioni

Të sigurojë të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Përmbajtja

Fjala Përshëndetëse	6
Hyrje	7
1 ERRU dhe veprimtaria gjatë vitit 2012	9
2 Ecuria e sektorit ujësjellës kanalizime gjatë vitit 2012	13
3 Analiza e performancës për shoqëritë ujësjellës kanalizime	17
3.1 Mbulimi i Kostove të Operimit dhe Mirëmbajtjes	22
3.2 Mbulimi i Kostos Totale	26
3.3 Norma e Arkëtimit	30
3.4 Eficienca e Stafit	34
3.5 Uji pa të Ardhura	38
3.6 Niveli i Matjes	42
3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	46
3.8 Cilësia e Ujit të Pijshëm	49
3.9 Mbulimi me Kanalizime	54
3.10 Perceptimi Rregullator	58
4 Renditja e shoqërive ujësjellës kanalizime sipas performancës për vitin 2012	62
5 Tema e veçantë për vitin 2012: Këndvështrimi i ERRU për shërbim me cilësi më të mirë	67
6 Konkluzione dhe perspektiva për të ardhmen	70
7 Aneks: Të dhënat Kryesore të Përzgjedhura	73

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Ujit
UK	Ujësjiellës Kanalizime
SHA	Shoqëri Aksionere
SHA U	Shoqëri Aksionere Ujësjiellës
SHA UK	Shoqëri Aksionere Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
TKP	Treguesit Kryesore të Performancës
USAID	United States Agency for International Development / Agjencia për Zhvillimin Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara
UNDP	United Nations Development Program / Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
IWA	International Water Association / Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit / Agjencia Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjiellës dhe Kanalizim e Kosovës.
O&M	Kosto operative dhe mirëmbajtje
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizime
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
BE	Bashkimi European
ISHP	Instituti Shëndetit Publik
DRSHP	Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik
ITUN	Implant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura

Fjala Përshëndetëse

Raporti i performancës është një mjet që rrit transparencën në sektor dhe nxit konkurrencën midis shoqërive ujësjellës kanalizime. Të qenë të bindur për këtë rëndësi rregullatore, për të dytin vit rradhazi ERRU publikon këtë raport. Raporti vjen si rezultat i një pune serioze dhe me profesionalizëm për të vënë në dukje çështjet më të rëndësishme të sektorit. ERRU, përmes analizës së performancës në këtë raport, dëshiron të nxisë shoqëritë që ofrojnë shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime të përmirësojnë punën e tyre në dobi të konsumatorit.

Në raport përveç analizës së treguesve të performancës, të përzgjedhur nga ERRU, për sektorin ujësjellës kanalizime, jepet dhe një analizë e detajuar e këtyre treguesve për çdo shoqëri. Në këtë mënyrë, jo vetëm shoqëritë shohin sesi kanë performuar krahasuar me një vit më parë por kanë mundësinë të krahasohen dhe me shoqëritë të tjera të ngjashme. Të gjitha palët e interesuara, shoqëritë, pronarët e tyre, këshillat mbikëqyrës dhe konsumatorët, njihen me performancën e sektorit në tërësi dhe çdo shoqërie në veçanti. Diversiteti i shoqërive për nga madhësia dhe performanca e shërbimeve, jep mundësinë për zgjedhjen e shembujve më pozitiv për t'i patur si model.



Analizimi i indikatorëve tregoi që shoqëritë kanë vazhduar përpjekjet e tyre për rritjen e qëndrueshmërisë financiare. Sikurse edhe në vitin paraardhës mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes vazhdon të ketë trend pozitiv, duke mbuluar tërësisht kostot nga të ardhurat.

Rritja tepër e vogël e orëve të furnizimit me ujë dhe përqindja e ulët të instalimit të matësave të ujit mbeten prioritet për ERRU, ende nën nivelin e objektivave të shoqërive në këtë drejtim. Niveli i humbjeve të ujit ose "ujit pa të ardhura" mbetet tregues problematik. Performanca mesatare e sektorit është përkeqësuar krahasuar me një vit më parë. Ne besojmë se shoqëritë ujësjellës kanalizime nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur kësaj çështje të rëndësishme. ERRU, kërkon nga të gjitha shoqëritë, dhe jo vetëm, të vlerësojnë "humbjet", duke bërë një analizë të detajuar të të gjithë faktorëve që ndikojnë dhe marrjen e të gjitha masave të nevojshme për reduktimin e tyre.

Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve mbetet në të njëjtin nivel me atë në vitin 2011. Investimet e kryera nga disa shoqëri për vënies në punë të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, me financimin e qeverisjes qendrore dhe donatorëve gjatë këtij viti do të japin efektet e tyre në vitin 2013. Këtë vit baza e të dhënave për raportin e performancës, është marrë sërish nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking. ERRU në bashkëpunim me NJMB ka përmirësuar cilësinë e të dhënave përmes inspektimeve të përbashkëta duke synuar rritjen e përgjegjshmërisë së shoqërive në raportimin e të dhënave. Megjithatë kjo çështje do të mbetet një sfidë për vitet e ardhshme. Është kënaqësi për mua që në emër të Komisionit Kombëtar Rregullator, të shpreh vlerësimin dhe falenderimin tonë për punonjësit e ERRU të cilët kanë punuar intensivisht për hartimin e këtij raporti. Falenderimi ynë i singertë për këshilltarët e GIZ, për bashkëpunimin dhe përkushtimin ndaj nesh.

Në fund, dëshiroj të përgëzoj performuesit më të mirë, si dhe ata me ecurinë më të mirë që kryesojnë tre grupimet për vitin 2012.

Avni Dervishi
Kryetar i Entit Rregullator të Ujit



Hyrje

Enti Rregullator i Ujit është institucion i pavarur publik, i krijuar në bazë të ligjit nr. 8102, datë: 28.03.1996, mbi "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Ligjërisht i mandatuar për të raportuar 'mbi gjendjen e sektorit' dhe të paraqesë rekomandimet e tij lidhur me masat që duhen marrë për përmirësimin e këtij sektori.

Raporti i Performancës për vitin 2012 paraqet rezultatet e vlerësimit të përgjithshëm të ecurisë së 57 shoqërive ujësjellës kanalizime mbi bazën e 10 treguesve kryesorë të performancës të përzgjedhur nga Komisioni Kombëtar Rregullator në vitin 2010. Duke pasur parasysh nevojën për qëndrueshmëri financiare në këtë sektor, TKP e përzgjedhur përqendrohen në vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe menaxhuese, si dhe në ato drejtime të ecurisë së shoqërive UK, efekti i të cilave ndihet në mënyrë më të drejtpërdrejtë nga konsumatorët.

Në këtë raport, analizohet fillimisht ecuria e secilës shoqëri më vete e më pas ato krahasohen me ecurinë e shoqërive të tjera. Në këtë mënyrë vihen në dukje si shoqëritë me performancën më të mirë, ashtu edhe ato me performancën më të dobët. Përmes raportit të performancës, vetë shoqëritë mund të vlerësojnë ecurinë e tyre duke e krahasuar me atë të shoqërive të tjera që operojnë në mjedise të ngjashme. Kështu ato mund të dallojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta e të mësojnë nga praktikat më eficiente operacionale dhe menaxhuese të më të mirëve.

Monitorimi i sektorit UK dhe publikimi i raportit të performancës ka për qëllim dhënien e mundësisë për të gjithë aktorët e interesuar, duke përfshirë edhe vetë konsumatorëve, që të shohin progresin e arritur në këtë sektor dhe të vlerësojnë performancën e operatorit që u ofron atyre shërbimin. Në këtë mënyrë raporti i performancës kthehet në një mjet të rëndësishëm që shtyn shoqëritë të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve.

Rezultatet e kësaj analize të performancës do të përdoren gjithashtu nga ERRU në procesin e ndryshimit të tarifave, duke qenë se ndryshimet tarifore tani varen nga arritja e objektivave të performancës të vendosura.

Publikimi i këtij raporti është vazhdimi i procesit të monitorimit të performancës së sektorit nga rregullatori. ERRU dëshiron të nxisë të gjithë aktorët si: shoqëritë, pronarët e tyre, këshillat mbikëqyrës, klientët, mediat si dhe vendimmarrësit politikë për t'u angazhuar në një dialog konstruktiv mbi sfidat aktuale të sektorit dhe ato në të ardhmen.

Në këtë raport janë analizuar vetëm shoqëritë ujësjellës kanalizime megjithëse shërbimi UK ofrohet edhe nga disa shoqëri të tjera që aktualisht nuk janë të liçensuara. ERRU po punon për të orientuar veprimtarinë e tij drejt integritetit të tyre brenda kuadrit rregullator.

Vendosja e objektivave për të ofruar shërbime eficiente dhe përmirësimi i performancës ka nevojë për të dhëna të sakta. Me përjashtim të një treguesi, analiza e performancës së paraqitur edhe në këtë raport është bazuar mbi të dhëna të vetëdeklaruar nga ana e shoqërive, të mbledhura dhe të përpunuara nga njësia e monitorimit dhe benchmarking pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime. Gjatë vitit 2012 nga eksperiencia e punës së entit me shoqëritë UK u konstatuan mosraportim, vonesa dhe pasaktësi në të dhënat e raportuara nga disa shoqëri. ERRU në bashkëpunim me NJMB punoi për plotësimin dhe saktësimin e tyre. Kjo përvojë risjell në vëmendjen e ERRU nevojën për të intensifikuar punën në drejtim të grumbullimit, verifikimit dhe saktësimit të të dhënave të paraqitura nga shoqëritë duke ushtruar aty ku është e nevojshme kompetencat e tij ligjore.

Raporti i performancës është i përbërë nga 6 pjesë ku:

Pjesa e parë jep shkurtimisht veprimtaritë kryesore të ERRU gjatë vitit 2012 duke bërë një përshkrim të shkurtër të veprimtarive dhe arritjeve.

Pjesa e dytë paraqet performancën e përgjithshme të sektorit në vijim të politikës së sektorit ujësjellës kanalizime të zbatuar nga ERRU, qeveria qendrore dhe njësitet e qeverisjes lokale.

Në pjesën e tretë e cila është edhe zemra e këtij raporti, paraqitet analiza e performancës së shoqërive, për secilin nga dhjetë TKP e marrë në shqyrtim.

Në pjesën e katërt bëhet renditja e shoqërive në bazë të rezultateve të arritura me performancën më të mirë.

Në pjesën e pestë të raportit trajtohet një temë e cila vjen këtë vit në lidhje me këndvështrimin e ERRU për të arritur një shërbim me cilësi më të mirë për konsumatorët. Kjo temë është e ndryshme nga një raport në tjetrin.

Raporti mbyllet me pjesën gjashtë ku paraqitet një përmbledhje e konkluzioneve kryesore. Në përfundim është një përmbledhje aneksesh me të dhëna të detajuara për shoqëritë UK dhe tarifatat që ato zbatojnë.



1

ERRU dhe veprimtaria gjatë vitit 2012



Fokusi i punës së Entit Rregullator i Ujit edhe gjatë vitit 2012, ka qenë i lidhur ngushtësisht me funksionet e tij kryesore, që janë: liçensimi dhe vendosja e tarifave për operatorët që veprojnë në sektorin Ujësjellës Kanalizimeve (UK). Një vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të metodologjisë së re të vendosjes së tarifave për 2 shoqëritë pilot (SHA UK Pogradec dhe SHA UK Fier) dhe për të gjitha aplikimet e tjera, deri në finalizimin e procesit me miratimin e tarifave nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Në fokus të ERRU është gjithashtu mbrojtja e konsumatorit dhe rritja e transparencës në sektor. Për këtë arsye, një rëndësi e veçantë i është kushtuar monitorimit të zbatimit të kontratës model nga të gjithë operatorët. ERRU ka qenë aktiv në këtë drejtim duke kërkuar që të gjithë operatorët e mëdhenj që aplikuan për ndryshim tarife të kishin organizuar paraprakisht seancën dëgjimore me klientët e tyre si një detyrim që rrjedh nga metodologjia e vendosjes së tarifave.

Gjatë vitit 2012 ERRU u fokusua gjithashtu në procesin e monitorimit të sektorit dhe të shoqërive UK. Publikimi i raportit të performancës nga ana e rregullatorit e ka ngritur në një nivel tjetër monitorimin dhe vlerësimin e krahasuar të shoqërive që operojnë në këtë sektor. Ky raport ka ndikuar edhe në ecurinë e shoqërive UK duke rritur transparencën dhe duke nxitur përmirësimin e performancës për secilën prej tyre nëpërmjet ndjekjes së "Best Practice" (Praktikave më të mira që promovohen në këtë raport).

Liçensimi

Në fund të vitit 2012, ERRU raportoi të jenë 50 shoqëri ujësjellës kanalizimesh të liçensuara kundrejt 57 shoqërive aktive në këtë sektor gjithësej. Ky është një tregues pozitiv duke pasur parasysh që në vitin 1998 kur ERRU filloi të bënte liçensimin si një kërkesë ligjore në sektorin UK, ishin vetëm gjysma e tyre të liçensuara.

Duhet nënvizuar se, pavarësisht punës serioze të Entit në këtë drejtim, njësitë e pushtetit vendor në qendra të vogla urbane nuk e qasin si domosdoshmëri dhe detyrim ligjor liçensimin e këtij shërbimi që ato ofrojnë për komunitetet e tyre.

Gjatë vitit 2012 kanë aplikuar për liçensë 28 shoqëri ujësjellës kanalizime, nga të cilat pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit të kërkuar janë liçensuar 17 prej tyre dhe 11 shoqëri të tjera janë në proces. Për herë të parë gjatë këtij viti ka aplikuar dhe është liçensuar SHA Ujësjellës Kanalizime Himarë. Gjithashtu, është bërë rinovimi i liçensave për efekt të ndryshimeve të drejtuesve ligjore apo teknike si edhe është bërë rinovimi i liçencës për efekt të mbarimit të afatit për 14 shoqëri të tjera.

Gjatë procesit të aplikimeve për pajisje me licensë apo rinovim license gjatë vitit 2012, nga ana e shoqërive që operojnë në sektorin UK, u hasën problematika jo të panjohura më parë për ERRU si: (i) ndryshimi i drejtuesit ligjor brenda një periudhe shumë të shkurtër (disa herë brenda një viti), (ii) vështirësi në gjetjen e një drejtuesi të kualifikuar teknik, (iii) mungesa e fondeve për funksionimin normal të shoqërisë, (iv) vështirësi për shlyerjen e pagesës së licencimit tek ERRU.

Janë evidentuar raste të disa njësive të qeverisjes vendore të cilat e kryejnë vetë shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura dhe nuk ia kanë transferuar këtë funksion shoqërive UK në varësi të njësisë përkatëse. Gjithashtu ka raste kur disa njësi vendore nuk e ofrojnë më vetë shërbimin ujësjellës kanalizime dhe e kanë transferuar tek shoqëria UK në pronësi të disa njësive vendore, por këto shoqëri kryejnë aktivitetin e tyre duke mos aplikuar dhe marrë miratimin për licencë nga ERRU.

Vendosja e tarifave

Në vitin 2012 u paraqitën pranë ERRU 10 kërkesa për ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Shoqëritë që aplikuan për ndryshimin e tarifave janë: SHA UK Pogradec, Fier, Gjirokastrë, Berat-Kuçovë, Lezhë, Lushnjë, Rrogozhinë, Durrës, Sha U Përmet dhe Bulqizë.

Kërkesat për ndryshimin e tarifave janë paraqitur në zbatim të “Metodologjisë për vendosjen e tarifave”, miratuar me vendimin të KKRR numër 28 datë 28.09.2011, zbatimi i të cilës filloi në vitin 2012.

Objektivi kryesor i ERRU në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit, ashtu siç parashikohet në vizionin dhe misionin e tij.

SHA UK Pogradec dhe SHA UK Fier u përzgjedhën si raste pilot për implementimin e kësaj metodologjie.

Procesi i vendosjes së tarifave është bazuar në:

- vlerësimin e kostove “të arsyeshme dhe të domosdoshme” për ofrimin e shërbimeve me efikasitet, me qëllim që konsumatorët të paguajnë vetëm kosto të justifikuara.
- vlerësimin e performancës duke synuar progres në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare, e cila do të çojë në mbulimin më të madh të kostove.

Niveli dhe natyra aktuale e mbulimit të kostove për shoqëritë që kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave është e ndryshme, prandaj edhe kostot e marra në konsideratë për vendosjen e tarifave janë të ndryshme. Bazuar në analizën e kostove është bërë korrigjimi i kostove në ato zëra ku rezultoi se rritja e tyre ishte e pajustifikuar.

ERRU u ka përcaktuar objektiva sasiore dhe cilësore të cilat duhet të përmbushen gjatë periudhave në vazhdim nga të gjitha shoqëritë që kanë aplikuar për ndryshim tarife pranë tij gjatë vitit 2012. Në objektivin operacional të ERRU është ndjekja e përmbushjes së këtyre objektivave nga ana e shoqërive gjatë vitit 2013. Këta tregues do të monitorohen me kujdes dhe do të jenë pjesë e analizës në procesin e aplikimit për ndryshim tarifash në të ardhmen.

Bazuar në metodologjinë e vendosjes së tarifave (me dy pjesë: “tarifë fikse” dhe “tarifë ndryshueshme” me blloqe në rritje për konsumatorët) vetëm SHA UK Pogradec e plotësoi këtë detyrim. Kjo shoqëri arriti të respektojë strukturën tarifore në krahasim me gjithë aplikuesit e tjerë, pasi ajo i ka pajisur të gjithë konsumatorët e saj me matës dhe ka një sistem faturimi të kompjuterizuar.

Sipas kësaj strukture, tarifat në bllokun e parë të konsumit (deri në 4.5 m³) janë më të ulëta se në bllokun e dytë të konsumit (mbi 4.5 m³). Kjo gjë i krijon mundësi konsumatorëve me të ardhura të ulëta të kursejnë ujin për të paguar me tarifën më të ulët.

Shoqëritë e tjera përfshi edhe SHA UK Fier (si rast pilot), nuk mundën të plotësonin kushtet për të aplikuar strukturën e tarifave me më shumë se një bllok konsumi për arsye të nivelit të ulët të pajisjes me matës të konsumatorëve, saktësisë së të dhënave në lidhje me nivelet e konsumit apo pamundësisë financiare për instalimin e sistemit të kompjuterizuar të faturimit dhe mungesës së kapaciteteve profesionale.

Nisur nga eksperiencia e dy rasteve pilot (SHA UK Pogradec dhe Fier) u vendos që të gjitha shoqëritë e tjera që aplikuan për tarifë të re gjatë vitit 2012, për vitin 2013 të aplikojnë strukturën e tarifave me një bllok konsumi. Për aplikimin pasardhës këtyre shoqërive u është kërkuar të plotësojnë regjistrin e konsumatorëve me qëllim saktësimin e të dhënave, të informatizojnë sistemin e faturimit, të marrin masa për pajisjen e konsumatorëve me matës, në veçanti të përfundojnë vendosjen e matësve për konsumatorët jofamiljarë si dhe të organizojnë seanca dëgjimore me konsumatorët.

Mbrojtja e klientit dhe rritja e transparencës

Gjatë vitit 2012 ERRU monitoroi me kujdes zbatimin e kontratës model me qëllim mbrojtjen e të gjithë klientëve të shoqërive ujësjellës kanalizime në Shqipëri dhe sigurimin që të gjithë do të trajtohen në përputhje me standardet e vendosura nga rregullatori. Proces i lidhjes së kontratës model ka ecur me ritme të kënaqshme. ERRU përgëzon punën e bërë gjatë vitit 2012 nga shoqëritë: SHA U Elbasan Fshat, SHA UK Gjirokastrë, SHA U Libohovë, SHA U Peshkopi dhe SHA U Shkodër Fshat të cilat e kanë përfunduar procesin e zbatimit të kontratës model me të gjithë konsumatorët. Gjithësesi mbetet ende punë për t'u bërë deri në finalizimin e të gjithë procesit. Janë 13 shoqëri UK të cilat nuk e kanë filluar ende procesin e zbatimit të kontratës si: SHA UK Kavajë, Malësia e Madhe, Peqin, Rogozhinë dhe Himarë.

Objektivat e vendosura nga ERRU mbi zbatimin e kontratës model për të gjithë konsumatorët publik dhe privat deri në fund të vitit 2011 ende nuk janë arritur. Përqindja e zbatimit të kontratës model në shkallë vendi për të gjithë klientët deri në fund të vitit 2012 është 17.8% ndërkohë që është arritur zbatimi për 29 % të klientëve privat dhe 68 % të klientëve publikë. Në fokus të punës së ERRU mbetet zbatimi i kontratës dhe në përputhje me udhëzimet e dhëna nga ERRU për të gjithë klientët e shoqërive UK në Shqipëri.

Metodologjia e vendosjes së tarifave promovoi transparencën duke sjellë si risi në procesin e aplikimit për ndryshim tarife ndarjen e konsumit në blloqe e cila lejon klientët me konsum të pakët uji të përfitojnë nga aplikimi i tarifës më të ulët për atë bllok.

Një tjetër risi e metodologjisë së vendosjes së tarifave ishte organizimi i seancës dëgjimore me publikun. Gjatë vitit 2012, shoqëritë pilot që aplikuan për ndryshim tarife organizuan për herë të parë seancë dëgjimore me publikun. Gjatë këtyre takimeve operatorët patën mundësi të shpjegojnë përpara klientëve të tyre arsyet se përse ata kërkojnë ndryshimin e tarifës si edhe paraqitën projektet dhe investimet që do të realizonin me të ardhurat e parashikuara.

¹ Vjen nga anglishtja dhe shumë i përdorur sot, ky nocion krahason ecurinë e treguesve të performancës së një kompanie me një kompani tjetër. Kryesisht përdoret si një matës i praktikave më të mira ose krahasimin e disa treguesve që identifikohen në një sektor të caktuar të industrisë në fjalë / në rastin tonë ujit.

Një tjetër moment i rëndësishëm në rritjen e transparencës është publikimi dhe prezantimi i raportit të performancës, në një seminar të organizuar nga ERRU ku marrin pjesë të gjitha shoqëritë e sektorit UK, institucionet partnere dhe donatorët. Ky raport vjen jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe si një nismë e re e monitorimit dhe benchmarking të shoqërive që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe/ose largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në Shqipëri. Nëpërmjet publikimit të këtij raporti, ERRU thelloi përpjekjet për rritjen e transparencës në sektor. Ky informacion është tepër i vlefshëm jo vetëm për shoqëritë, por njëkohësisht edhe për konsumatorët të cilët janë në fokusin e punës së ERRU. Raporti është një publikim i përvitshëm me anë të të cilit synohet monitorimi sistematik i shoqërive dhe publikimi i informacionit për të gjithë publikun. Në këtë mynyrë ERRU realizon misionin e tij duke siguruar një sektor të orientuar drejt kërkesës së konsumatorëve. Faqja elektronike zyrtare e ERRU (www.erru.al), e cila përditësohet në mënyrë të vazhdueshme me informacionin më të fundit, është një mjet efikas që rrit transparencën e institucionit ndaj konsumatorit dhe aktorëve të tjerë të interesuar në këtë sektor. Gjithashtu në përputhje me kërkesat ligjore, ERRU ankesat e konsumatorëve që nuk kanë gjetur zgjidhje pas ankimit tek operatori që i ofron shërbimin.



2

Ecuria e sektorit ujësjellës kanalizime gjatë vitit 2012



Në këtë pjesë të raportit jepet një pamje e përgjithshme e zhvillimeve më të rëndësishme në sektorin ujësjellës kanalizime gjatë vitit 2012, progresit të arritur duke patur parasysh zhvillimin e politikave të reja të paraqitura në objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017, objektivave për financimin e sektorit dhe objektivave për tregueset e performancës të përcaktuar nga ERRU.

Zhvillimet Kryesore

Edhe këtë vit ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sipas standarteve dhe parashikimeve ligjore ka njohur progres. Aktualisht, nga 57 operatorë 50 janë pajisur me licensë për ushtrimin e aktivitetit të tyre dhe 44 prej tyre aplikojnë tarifa të miratuara nga ERRU. Kjo situatë është rezultat i një bashkëpunimi të suksesshëm të ERRU me operatorët për rregullimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura brenda kuadrit ligjor. Objektivi i ERRU është pajisja me licensë dhe aplikimi i tarifave të miratuara prej tij për të gjithë operatorët, duke krijuar një mjedis rregullator të qëndrueshëm dhe transparent në sektor.

Operatorët ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë për 80.8% të popullsisë në zonat e tyre të shërbimit. Gjatë vitit 2012 numri i klientëve që e përfitojnë këtë shërbim është rritur me 4.9% kundrejt vitit 2011. Ndërsa shërbimi i kanalizimeve vazhdon të jetë prapa atij të furnizimit me ujë në shumë aspekte. Ky shërbim nuk i ofrohet të gjithë klientëve në zonën e shërbimit. Në vitin 2012, nga 57 operatorë vetëm 30 prej tyre ofrojnë shërbimin e kanalizimeve. Përpunimi i ujërave të ndotura është kryer nga katër operatorë të cilët kanë në funksionim impiante për trajtimin e tyre ku përfshihen SHA UK Kavaja, SHA UK Pogradec, SHA UK Vlorë dhe së fundi në vitin 2012 SHA UK Korçë. Këto Impiante përpunojnë mbi 37,400 m³ në ditë dhe ju shërbejnë afro 235,000 banorëve.

Përmirësimi i këtij shërbimi kërkon akoma më shumë përpjekje për të rritur shkallën e mbulimit me këtë shërbim në vend, duke ruajtur në të njëjtën kohë shkallën e masave sanitare dhe mbrojen e mjedisit. Është vënë re se disa njësi të pushtetit vendor ofronë shërbimet ujësjellës kanalizime por nuk janë të licensuar për këto aktivitete nga ERRU. Objektivi i entit gjatë vitit 2012 ka qenë evidentimi dhe gjetja e rrugëve më të lehta dhe shpejta ligjore për të bërë rregullimin e tyre në mënyrë sa më objektive.

Sektori është duke u zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme. Pjesa më e madhe e treguesve kanë një rritje të lehtë ose nivele të njëjta me ato të vitit të kaluar. Shoqëritë ujësjellës kanalizime kanë bërë më shumë përpjekje në drejtim të përmirësimit të situatës financiare. Aktualisht të ardhurat e shoqërive UK mbulojnë mesatarisht mbi 100% kostot operative dhe mirëmbajtje (O&M) për sektorin. Në vitin 2012 si të ardhurat nga aktiviteti kryesor UK dhe kostot kanë patur tendencë në rritje. Të ardhurat në sektor janë rritur rreth 8% kundrejt vitit 2011 ndërsa kostot O&M janë rritur me 6.7%.

Në rritjen e të ardhurave ka ndikuar: rritja e vëllimit të faturuar por edhe ndryshimi i tarifave nga ERRU për 14 operatorë. Kjo e fundit ka çuar në rritjen e pavarësisë dhe qëndrueshmërisë financiare të shoqërive dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve.

Për vitin 2012, treguesi me nivelin më të mirë të arritur dhe tendencën pozitive është norma e arkëtimit. Mbulimi i kostove dhe efienca e arkëtimit kanë tejkaluar objektivat strategjikë dhe nivelet e benchmarking të performancës së mirë të ERRU. Megjithatë ende janë shumë operatorë që nuk janë në gjendje të financojnë qoftë edhe veprimtaritë e tyre kryesore operacionale dhe janë të varur nga mbështetja financiare e donatorëve dhe e subvencioneve shtetërore. Edhe gjatë vitit 2012 qeveria ka akorduar subvencione por krahasuar me vitin e mëparshëm ka ulje të tyre. Ky është një sinjal që operatorët duhet të punojnë për të siguruar pavarësinë ekonomike dhe të realizojnë të ardhura për përballimin e shpenzimeve.

Performanca e Përgjithshme e Sektorit

Në vitin 2012 rezultatet e treguesve kryesorë të performancës për sektorin kanë qenë të ndryshme. Të dy shërbimet ai i furnizimit me ujë të pijshëm dhe ai i kanalizimeve kanë ruajtur pothuajse të njëjtat nivele. Përmirësimi i mbulimit të kostove O&M dhe totale kanë çuar në përmirësimin e situatës financiare në sektor. Kjo ka bërë që të tejkalohen objektivat e qeverisë si dhe objektivat e benchmarking për performancës të mirë të vendosur nga ERRU në mbulimin i kostove O&M. Nga analiza e thelluar e treguesve të performancës rezulton se për disa shoqëri, kryesisht të vogla, të ardhurat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar qoftë as gjysmën e kostove të tyre. Një mundësi për të tejkaluar këtë situatë nga këto shoqëri do të ishte bashkimi i tyre me shoqëri më të mëdha² duke rritur aftësinë menaxheriale.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e 10 treguesve të performancës së sektorit për vitin 2012 kundrejt vitit 2011. Niveli i këtyre treguesve është krahasuar me objektivat e paraqitura në strategjinë aktuale të sektorit për vitin 2012 si dhe nivelet sfiduese të benchmarking për performancë të mirë të vendosura nga ERRU.

Tabela 1. Përmbledhje e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizime për vitin 2012

Treguesit e Performancës	2011	2012	Tendenca e Performacës	Benchmark e Performacës së Mirë të ERRU	Objektivat e Strategjisë së Sektorit për vitin 2012
Mbulimi i Furnizimit me Ujë	80.80%	80.8%	=	n/a	n/a
Mbulimi me Kanalizime	50.80%	51.0%	↗	75%	n/a
Cilësia e Ujit të Pijshëm	n/a	n/a	n/a	98%	n/a
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	10.9	10.8	↘	18	13
Mbulimi i Kostos Totale ³	79.4%	82.7%	↗	80%	70%
Mbulimi i Kostove O&M ⁴	105.20%	106.3%	↗	100%	95%
Norma e Arkëtimit	79.90%	90.9%	↗	82%	88%
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje)	9.3	9.3	=	4/6/10	n/a
Uji pa të Ardhura	63.50%	67.1%	↘	30%	57%
Niveli i Matjes	50.60%	55.1%	↗	85%	52%

Burimi informacionit: ERRU

Për vitin 2012, norma e arkëtimit është treguesi me vlerësimin më pozitiv. Arkëtimet kanë tejkaluar objektivin e benchmarking të ERRU si edhe objektivin e strategjisë kombëtare në sektor. Norma e arkëtimit është rritur 11% në krahasim me vitin 2011. Ecuria është mëse pozitive duke pasur parasysh që në vitin 2011 niveli i arkëtimit u ul me 4.3% krahasuar me vitin 2010.

Efiçenca e stafit është tregues i cili nuk ka shënuar ndonjë ndryshim krahasuar me një vit më parë, 9.3 staf për 1000 lidhje, gati dy herë më i lartë sesa ai në shoqëritë më të mira në vendet e rajonit.

² Një nga objektivat e strategjisë kombëtare 2007-2015 është rajonalizimi dhe rishikimi i madhësisë së shoqërive UK. Ky objektivi është një diskutim ende i hapur me të gjithë aktorët e interesuar ndërkohë që nuk ka një qëndrim të qartë se cila do të jetë zgjidhja për të arritur këtë objektivi.

³ Treguesi mbulimi i kostove totale në vitin 2012 duke korrigjuar edhe shifrat e vitit 2011 merr në konsideratë edhe të ardhurat e tjera si: nga lidhjet e reja, tarifa e shërbimit, rilidhjet etj.

⁴ Edhe ky tregues është rillogaritur duke marrë parasysh të njëjtat të ardhura të tjera sikurse citohet tek mbulimi i kostove totale.

Rezultatet e performancës teknike nuk janë të kënaqshme. Niveli i ujit pa të ardhura vazhdon të mbetet i lartë dhe është rritur në 2012 me 3.9% kundrejt vitit 2011. Niveli i ujit pa të ardhura për sektorin, në vitin 2012 është 67.1% tregues që ende nuk ka arritur objektivin e përcaktuar në strategjinë e sektorit, dhe është gati dy herë më i lartë se sa benchmarking i ERRU. Prandaj reduktimi i nivelet të ujit pa të ardhura mbetet një nga fushat prioritare të punës për ERRU dhe për shoqëritë.

Një tregues tjetër që merr vlerësime pozitive është niveli i matjes. Niveli i këtij treguesi në vitin 2012 është rritur me 5.5% krahasuar me një vit më parë duke arritur mbi 55% të numrit të klientëve. Ky nivel ka tejkaluar objektivin strategjik të sektorit por jo nivelin e benchmarking të performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Për ERRU eliminimi i praktikës së faturimit aforfe, që momentalisht mbetet në nivele të larta dhe zbatimi i programeve për rritjen e numrit të matesave të instaluar në rrjetin ujësjellës (matësa kryesore dhe individual) duhet të jetë në fokusin e punës së operatorëve si pjesë e strategjisë për uljen e nivelit të ujit pa të ardhura.

Treguesit kryesorë të përdorur për vlerësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve janë: (i) vazhdimësia e shërbimit dhe (ii) cilësia e ujit të pijshëm. Objektivat e strategjisë kombëtare dhe ato të performancës së mirë nga ERRU kërkojnë që shoqëritë të ofrojnë shërbim të furnizimit me ujë përkatësisht 12 dhe 18 orë në ditë. Nisur nga këta tregues ecuria e sektorit nuk është e duhura. Në vitin 2012 kohëzgjatja mesatare e orëve të furnizimit me ujë, krahasuar me një vit më parë është rritur me 0.7 orë, dhe niveli mesatar i arritur 11.6 orë/ditë. Pjesa më e madhe e klientëve nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm me ujë vjen edhe si rezultat i ndërprerjeve për shkaqe teknike dhe si pasojë e amortizimit të rrjetit të shpërndarjes, gjë e cila ndikon në cilësinë e ujit për konsum publik.

Instituti i Shëndetit Publik dhe Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik bëjnë kontrollin dhe monitorimin e përditshëm të të dhënave të cilësisë së ujit për konsum publik. Ky kontroll realizohet kryesisht në zonat urbane të vendit, por edhe vetë operatorët bëjnë kujdes për trajtimin e ujit të pijshëm. ERRU ka në mandatin e tij për mbrojtjen e konsumatorit edhe pse nuk është institucioni drejtpërdrejtë përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit. Për këtë arsye është forcuar bashkëpunimi me ISHP dhe DRSHP për të monitoruar më mirë furnizimin me ujë “të pastër” të qytetarëve.

Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve është treguesi i ndikimit të këtij shërbimi në mjedis. Niveli i këtij shërbimi në zonat urbane është në përputhje me objektivat e sektorit ndërsa mbulimi me shërbime në zonat rurale është ende në nivele shumë të ulëta. Nevoja urgjente për të përmirësuar mbrojtjen e konsumatorëve dhe mjedisit kërkon masa konkrete për të adresuar këtë problem. Një nga mënyrat direkte të zbatuara nga qeveria shqiptare është investimi në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Kjo masë pritet të përmirësojë situatën në disa qytete. Gjatë vitit 2012 janë shtuar si vepra të përfunduara dy impiante ai në Korçë dhe Vlorë. Jo vetëm rritja e shkallës së mbulimit me kanalizime por edhe trajtimi i ujërave të ndotura do të ndikojë në cilësinë e këtij shërbimi.

3

Analiza e performancës për shoqëritë ujësjellës kanalizime



Në këtë pjesë të raportit bëhet një analizë e performancës individuale të secilës prej 57 shoqërive ujësjellës kanalizime. Qëllimi i analizës është identifikimi i shoqërive me performancën më të mirë dhe ato me performancë të dobët për vitin 2012, si dhe ndryshimet që nga viti 2010 duke nxjerrë në fund konkluzionet përkatëse bazuar në këto rezultate.

Treguesit Kryesorë të Performancës

Lista e mëposhtme paraqet treguesit kryesorë të performancës që Komisioni Kombëtar Rregullator ka miratuar për monitorimin dhe vlerësimin e performancës të paraqitur në këtë pjesë. Këta tregues pasqyrojnë një pjesë të madhe të detyrave që shoqëritë duhet të kryejnë për të ofruar shërbime cilësore dhe eficiente.

Tabela 2. Pasqyra e treguesve kryesorë të performancës 2012

TKP	Përshkrimi
1 – Mbulimi i Kostove O&M	Pjesa e kostove operative dhe mirëmbajtjes (përfshijë amortizimin dhe kostot kapitale) që mbulohen nga të ardhurat.
2 – Mbulimi i Kostos Totale	Pjesa e kostove totale për shërbimet e ofruara që mbulohen nga të ardhurat e shoqërisë.
3 – Norma e Arkëtimit	Raporti ndërmjet të ardhurave të arkëtuara dhe shumës së faturuar ndaj klientëve.
4 – Efienca e Stafit	Numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje.
5 – Uji pa të Ardhura	Pjesa e ujit të prodhuar që nuk i faturon klientëve.
6 – Niveli i Matjes	Pjesa e lidhjeve me matës (numri i klientëve) si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të lidhjeve (klientëve).
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	Orët mesatare të furnizimit me ujë në ditë.
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm	Pjesa e testeve për cilësinë e ujit të cilat përmbushin standardet bakteriologjike (koliforme) dhe ato të klorit mbetës.
9 – Mbulimi me Kanalizime	Pjesa e popullsisë brenda zonës së shërbimit të një shoqërie të cilës i ofrohet shërbim kanalizimi, por jo domosdoshmërisht trajtimi i ujërave të ndotura.
10 – Perceptimi Rregullator	Është vlerësimi i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kuadrin rregullator.

Në përzgjedhjen e TKP u është dhënë përparësi atyre treguesve që kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në situatën ekonomike të shoqërive si dhe në kapacitetet aktuale menaxhuese pasi nëpërmjet tyre do të arrihet përmirësimi i shërbimeve dhe arritja e qëndrueshmërisë afatgjatë financiare. Në listën e TPK përfshihen edhe tregues të cilët masin fusha të performancës që ndikojnë drejtpërsëdrejti tek konsumatorët. Si treguesit me më shumë interes për konsumatorët mund të përmendim orët e shërbimit dhe cilësia e ujit të pijshëm.

Tregues si: (i) niveli i matjes apo (ii) mbulimi me shërbimet e kanalizimeve kërkojnë investime kapitale për të rritur nivelin e tyre. Gjithsesi, shumë tregues të tjerë varen drejtpërsëdrejti nga puna e shoqërive siç janë: norma e arkëtimit, eficientia e stafit, uji pa të ardhura si dhe mbulimi i kostove. Në këta tregues duhet të përqendrohen përpjekjet e brendshme të shoqërive, sidomos ajo e drejtueve të tyre. ERRU do të analizojë performancën për të dy llojeve e TKP (atyre që kërkojnë investime dhe atyre që varen vetëm nga menaxhimi) si dhe do të krahasojë nivelin e tyre kundrejt objektivave strategjike të sektorit.

Së pari është analizuar performanca individuale e çdo shoqërie e më pas është bërë krahasimi i shoqërive për të identifikuar performuesit më të mirë dhe praktikat më të mira në vend. Perceptimi rregullator është një tregues tjetër i analizës tonë, përmes të cilit vlerësohet bashkëpunimi i shoqërive në procesin rregullator duke mbështetur përpjekjet e ERRU për të krijuar një mjedis rregullator transparent dhe të qëndrueshëm.

Analiza e Performancës: Grupet e Shoqërive

Shoqëritë ujësjellës kanalizime janë ndarë në tre grupe në mënyrë që të arrihet një analizë sa më reale e performancës së tyre. Secili grup përfshin si shoqëritë ujësjellës ashtu dhe ato ujësjellës kanalizime. ERRU ka vendosur që shoqëritë të grupohen sipas numrit të lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe jo madhësisë së zonës së shërbimit, si një mënyrë e mirë për të bërë dallimin ndërmjet shoqërive të mëdha apo të vogla.

Tabela 3. Grupi i shoqërive

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjellës	10
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës	21
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjellës	26

Burimi informacionit: ERRU

Tabela 4. Ndarja e shoqërive në tre grupe

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i lidhjeve (ujësjellës)
GRUPI 1			GRUPI 3		
UK	Tiranë	166,829	U	Divjakë	2,789
UK	Durrës	72,112	UK	Peqin	2,758
U	Vlorë	39,463	U	Ura Vajgurore	2,703
UK	Elber sh.p k	29,434	U	Bulqizë	2,676
UK	Fier	27,257	U	Delvinë	2,595
UK	Shkodër qytet	26,880	U	Bilisht	2,372
UK	Berat-Kuçovë	24,915	U	Shkodër Fshat	2,165
UK	Kavajë	22,508	UK	Fushë Krujë	2,149
UK	Korçë	20,759	U	Orikum	1,875
U	Elbasan Fshat	17,143	U	Malësi e Madhe	1,841
GRUPI 2			U	Tropojë	1,769
UK	Sarandë	14,129	U	Çorovodë	1,760
UK	Pogradec	13,837	UK	Ersekë	1,660
UK	Lushnjë	10,541	U	Polican	1,621
UK	Gjirokastër	9,188	UK	Selenicë	1,506
UK	Lezhë	7,089	UK	Mirditë	1,204
U	Korçë Fshat	5,929	UK	Bashkia Pukë	1,107
U	Lushnjë Fshat	5,843	U	Has	1,078
U	Kurbin	5,289	U	Këlcyrë	1,002
UK	Kukës	4,973	U	Vau i Dejës	880
U	Patos	4,779	UK	Libohovë	783
UK	Librazhd	4,681	UK	Fushë Arrëz	540
UK	Burrel	4,305	UK	Pukë Fshat	524
UK	Rrogozhinë	4,129	U	Gjirokastër Fshat	500
UK	Mallakastër	4,002	UK	Rubik	498
U	Gramsh	3,873	UK	Krastë	394
U	Novoselë	3,750	Burimi informacionit: ERRU		
U	Tepelenë	3,680			
UK	Krujë	3,554			
U	Peshkopi	3,327			
U	Përmet	3,236			
UK	Himarë	3,000			

Analiza e performancës: benchmarking

Për efekt të analizës për secilin TKP janë përcaktuar kufijtë e performancës së pranueshme. Siç mund të shikohet nga grafiku i mëposhtëm vija e verdhë në grafikët e analizës së performancës tregon nivelin e objektivit ose benchmarking e performancës së mirë; gjithçka poshtë këtij kufiri e shënuar me vijë të kuqe konsiderohet si performancë e dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave performancës së “pranueshme” nga njëra anë tregon përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme. Në tabelën 5 tregohen kufijtë minimalë dhe maksimalë të përcaktuar për secilin TKP.




Figura 1. Shembulli i Grafikëve të analizës së TPK-ve

Tabela 5. Benchmarking për treguesit kryesorë të performancës

Treguesit Kryesorë të Performancës		Benchmarking		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efienca e Stafit (numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje) ⁵	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji pa të Ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i Matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥ 18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤ 8 orë/ditë
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm		≥ 98%	90 - 95%	≤ 90%
9 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%
10 – Perceptimi Rregullator		n/a	n/a	n/a

Renditja e Shoqërive Ujësjellës Kanalizime

ERRU ka ndërtuar një sistem pikësh dhe renditjeje për të vlerësuar performancën e përgjithshme të secilës prej shoqërive duke marrë në analizë 9 nga 10 TKP-të. Çdo treguesi i është caktuar një peshë specifike dhe pikët e dhëna pasqyrojnë performancën e shoqërisë kundrejt niveleve të benchmarking, të vendosura nga ERRU. Për të bërë krahasimin e shoqërive ujësjellës kanalizime, renditja e tyre bazohet në shumën totale të pikëve të grumbulluar nga analiza e detajuar e secilit TPK, sipas tabelës së paraqitur dhe analizuar në pjesën e katërt të raportit ku flitet për renditjen e shoqërive në vitin 2012.

Siç tregohet në tabelën 5, performancës baraz ose mbi nivelin e benchmarking i jepen pikët maksimale. Për shumicën e treguesve, kur performanca është nën benchmarking për performancë të mirë shoqëria vlerësohet vetëm me një pjesë të pikëve të përcaktuara. Për treguesit si efienca e stafit, ujit pa të ardhura, norma e arkëtimit dhe cilësia e ujit të pijshëm, performanca e dobët penalizohet rëndë duke mos i dhënë asnjë pikë. Në këtë rast, vlerësimi me pikë bëhet nëse performanca aktuale është brenda kufirit të performancës së pranueshme.

⁵ Për TKP Efienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsie më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

3.1 Mbulimi i Kostove të Operimit dhe Mirëmbajtjes

Treguesi “Mbulimi i Kostove O&M” shpreh se deri në çfarë mase kostot e drejtpërdrejta O&M (pa amortizimin) mbulohen nga të ardhurat e realizuara. Nëpërmjet këtij treguesi vlerësohet situata financiare e shoqërisë duke nxjerr në pah aftësitë e shoqërisë për të mbuluar kostot bazike të saj me anë të të ardhurave nga burimet e veta. Zërat kryesorë të kostove O&M janë kostot për personelin, kimikatet, energjinë dhe kosto të tjera. Këto kosto duhet të jenë të arsyeshme dhe të justifikueshme nga pikëpamja ekonomike. Në 2012, ky tregues ishte në nivelin 106.3% në shkallë sektori duke shënuar rritje në krahasim me një vit më parë (niveli i të cilit ishte 105.2%). Mbulimi i plotë i kostove O&M, paraqitur me vijën e verdhë në grafikët e performancës më poshtë, është përcaktuar si benchmarking i performancës së mirë nga ERRU.

Grupi i parë i shoqërive:

Për vitin 2012, SHA UK Tiranë vazhdon të kryesojë grupin e parë, si shoqëria me performancën më të mirë, e ndjekur nga SHA UK Korçë, Elber SHPK, SHA UK Shkodër dhe SHA UK Berat-Kuçovë, të cilat kanë arritur 100% mbulim të kostove O&M, duke përmbushur në këtë mënyrë benchmarking e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Përmirësimin më të lartë të këtij treguesi e ka arritur SHA UK Fier me 27.7% krahasuar me vitin e kaluar duke shënuar në këtë mënyrë shoqërinë me progresin më të madh në vitin 2012. Gjithashtu, progres kanë bërë SHA U Elbasan Fshat (20.7%) dhe SHA UK Durrës (13.7%). Krahasuar me vitin 2010, përmirësim të ndjeshëm në këtë tregues kane arritur Elber SHPK me 43.5%.




Figura 2. Mbulimi i kostove O&M për grupin 1 në vitin 2012

Shoqëria me performancën më të dobët në grupin e parë midis gjithë shoqërive për vitin 2012 është SHA U Elbasan Fshat, ku mbulimi i kostove O&M për vitin 2012 është 71.4%. Gjithashtu, SHA U Vlorë dhe SHA UK Durrës vazhdojnë të funksionojnë në kufijtë e performancës së dobët poshtë vijës së kuqe. Mbulimi i kostove O&M nga të ardhurat për këto dy shoqëri është përkatësisht 72.7% dhe 75%. SHA U Vlorë regjistron edhe tendencën më të madhe në rënie (-63.2%) e ndjekur nga SHA UK Tiranë (-21.3%), dhe SHA UK Shkodër (-5.7%). SHA U Vlorë ka një rritje të shpenzimeve operative për shkak se me marrjen e shërbimit të kanalizimeve që më parë bëhej nga Bashkia, shoqëria po punon për përmirësimin e sistemit.

Grupi i dytë i shoqërive:

Në këtë grup, nga 19 shoqëri vetëm 6 prej tyre kanë arritur mbulim 100% të kostove O&M për vitin 2012. Këto shoqëri janë përkatësisht: SHA UK Gjirokastrë, SHA UK Pogradec, SHA U Peshkopi, SHA UK Librazhd, SHA U Gramsh dhe SHA UK Krujë. Nivelin më të mirë të këtij treguesi e ka arritur SHA UK Gjirokastrë me 132.5%. SHA U Patos vazhdon të jetë shoqëria me performancën më të dobët edhe për këtë vit, ku vetëm 23.6% e kostove O&M mbulohen nga të ardhurat. Nën kufirin e performancës së dobët për këtë tregues (80% treguar nga vija e kuqe) renditen edhe nëntë shoqëri të tjera: SHA U Tepelenë me 76.5%, SHA U Lushnjë Fshat me 76.4%, SHA UK Kukës me 72%, SHA U Kurbin me 51%,

UK Rrogozhinë me 46.4%, SHA UK Mallakastër me 45.5% dhe SHA U Korçë Fshat me 36.9%.




Figura 3. Mbuli i kostove O&M për grupin 2 në vitin 2012

SHA UK Gjirokastrë jo vetëm që kryeson grupin e dytë me nivelin më të lartë të arritur por gjithashtu kjo shoqëri ka arritur edhe progresin më të mirë në përmirësimin e këtij treguesi kundrejt një viti më parë. Nëse krahasimi bëhet me shifrat e vitit 2010, përmirësimin më të mirë në mbulimin e kostove O&M e ka arritur SHA U Lushnje Fshat me 29.7% po kështu SHA U Tepelenë me 25.8%, SHA UK Lezhë me 18.5% SHA U Kurbin me 17.9% dhe SHA U Përmet me 16%. Këto shoqëri kanë bërë përpjekje konstante për të përmirësuar situatën e tyre financiare. Në përmirësimin e raportit ndërmjet kostove dhe të ardhurave kanë ndikuar mbajtja nën kontroll e kostove, rritja e të ardhurave si rezultat i përmirësimit të nivelit të faturimit dhe rritja e tarifave.

Nga 2011 deri në 2012 është SHA UK Krujë shoqëria që ka shënuar rënien më të madhe në mbulimin e kostove O&M me (-33.8%). Por edhe në krahasim me vitin 2010 kjo shoqëri ka patur ecuri shumë negative (-42.4%), e ndjekur nga: SHA UK Pogradec (-29.1%), SHA U Burrel (-27.9%) SHA UK Rrogozhinë (-14%), dhe SHA U Peshkopi (-13.2%).

Grupi i tretë i shoqërive:

Në këtë grup, vetëm 2 nga 28 shoqëri e kanë arritur nivelin e benchmarking për vitin 2012 duke mbuluar më shumë se 100% të kostove O&M. Ndërsa 11 shoqëri të vogla nuk mund të mbulojnë as 50% të kostove O&M. Performanca më e mirë e këtij treguesi është arritur nga SHA U Malësi e Madhe me 161.9%, dhe shoqëria me performancën më të dobët është SHA U Pukë Fshat, me vetëm 23.7%.




Figura 4. Mbulimi i kostove O&M për grupin 3 në vitin 2012

Në vitin 2012 krahasuar me një vit më parë ky tregues ka ecuri pozitive për këtë grup, pasi për 21 nga 28 shoqëritë ka pësuar rritje. SHA U Malësi e Madhe (81.6%), SHA UK Pukë (20.9%), SHA UK Mirëditë (17%), SHA U Bulqizë (16.1%) SHA U Shkodër Fshat (15.7%) dhe SHA U Orikum (14.1%) kanë shënuar rritjen më të madhe lidhur me këtë tregues.

Nga ana tjetër, shoqëritë e mëposhtme kanë përkeqësuar ndjeshëm mbulimin e kostove O&M me të ardhurat e tyre krahasuar me një vit më parë: SHA U Peqin (-19.4%), SHA U Divjakë (-12.1%) dhe SHA U Ura Vajgurore (-11.4%).

Përfundime

Ecuria e mbulimit të kostove operative dhe mirëmbajtje në vitin 2012 është pozitive. Niveli i mbulimit është rritur lehtësisht kundrejt vitit 2011. Nga analiza e 57 shoqërive gjatë vitit 2012, 33 prej tyre mbulojnë me të ardhura më pak se 80% të kostove O&M. Për një pjesë të shoqërive niveli i mbulimit të kostove O&M shkon nga 50 – 80%, situata mbetet problematike dhe vështirëson vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit. Edhe pse përgjithësisht këto shoqëritë kanë rritur nivelin e të ardhurave, vihet re se shumë zëra të kostove O&M janë rritur: kosto e energjisë, shpenzimet për personelin etj. Kjo shpjegon rikrijimin e borxheve të reja për faturën e energjisë gjatë viteve 2011 dhe 2012. Në këtë mënyrë subvencioni i herëpashershëm për shlyerjen e borxheve të krijuara nga shoqëritë nuk është zgjidhja e problemit. Shoqëritë gjithashtu duhet të përmirësojnë administrimin, duke rritur faturimin dhe arkëtimin si një masë kyçe për përmirësimin e mbulimit të kostove O&M. Gjithashtu përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore; reduktimi i stafit të tepërt dhe rritja e efikasitetit në punë mund të përkthen në kursime të konsiderueshme financiare.

ERRU do t'u vijë në ndihmë shoqërive të arrijnë balancë më të mirë mes kostove dhe të ardhurave nëpërmjet rregullimit të tarifës. Gjatë vitit 2013 shoqëritë do të monitorohen për përmbushjen e objektivave të performancës në lidhje me tarifat e reja.

Në zbatim të metodologjisë për vendosjen e tarifave, miratimi i rritjes së tarifave do të jetë i kushtëzuar me arritjen e objektivave të përcaktuar të performancës.

3.2 Mbulimi i Kostos Totale

Mbulimi i kostove totale të shoqërisë është treguesi final që jep gjendjen financiare të shoqërisë. Duke i shtuar kostot e amortizimit dhe ato kapitale (interesat dhe shlyerjen e huave) kostove O&M, krijohet një pamje më e qartë e efijencës së shoqërisë. Mbulimi i këtyre kostove është vendimtar për një shoqëri që kërkon të zgjerojë fushën e aktivitetit dhe cilësinë e shërbimeve të saj. Për vitin 2012, nga analiza e këtij treguesi rezulton se sektori e ka rritur mbulimin e kostove totale me 3.3 pikë përqindjeje kundrejt vitit 2011 (arriti në 82.7 nga 79.4% që ishte një vit më parë). Ky nivel tregon një zhvillim edhe më pozitiv duke e krahasuar me objektivin e strategjisë (70%) ndërkohë që edhe objektivi i ERRU është arritur (80%).

Grupi i parë i shoqërive:

Analiza e këtij treguesi në grupin e parë rendit SHA UK Tiranë me nivelin më të lartë të mbulimit të kostove totale. Kjo shoqëri ka arritur të mbledhë detyrimet e prapambetura. Kufirin e benchmarking për performancë të mirë (80%) e kanë kapërcyer edhe shoqëritë Elber shpk (104.3%), SHA UK Shkodër (95.1%) dhe SHA UK Korçë (87.1%). Shoqëria me ecurinë më të dobët është SHA UK Kavajë e cila renditet në fund të grupit për performancë financiare shumë të dobët, me vetëm 39.4% mbulim të kostos totale.




Figura 5. Mbulimi i kostove totale për grupin 1 në vitin 2012

SHA UK Fier është shoqëria që paraqet rritjen më të madhe të këtij treguesi me 21.8% por edhe shoqëri të tjera kanë patur ecuri pozitive në mbulimin e kostos totale si SHA UK Durrës me 9.8% dhe SHA UK Tiranë me 7.4%. Shoqëria SHA U Vlorë është përballur me zhvillimin më negativ të këtij treguesi i cili ka rënë kundrejt një viti më parë me 46.7%.

Krahasuar me nivelin e këtij treguesi në vitin 2010, rezulton se Elber shpk ka bërë përmirësime të dukshme gjatë dy viteve të fundit, ku mbulimi i kostove totale është rritur me 38.4% (rritje për të dyja vitet së bashku). SHA U Vlorë vazhdon të ketë rënie kundrejt vitit 2010 kur niveli i mbulimit të kostove totale për këtë shoqëri ishte 103%. Sot shoqëria po përballlet me rënie drastike kundrejt këtij treguesi me mbi 61%. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i shtimit të aktivitetit me shërbimin e kanalizimeve që më parë kryhej nga bashkia Vlorë.

Grupi i dytë i shoqërive:

SHA UK Gjirokastrë është shoqëria që kryeson grupin e dytë me nivelin më të lartë të mbulimit të kostos totale për vitin 2012 (122.1%). Shoqëri të tjera si SHA UK Pogradec (91.6%), SHA U Peshkopi (87.4%), SHA UK Librazhd (86.8%) dhe SHA U Gramsh (82.3%) renditen mbi nivel e performancës së mirë të benchmarking të mbulimit të kostos totale. Ndërsa SHA U Patos renditet e fundit në grupin e dytë me 22.4% mbulim të kostos totale. Listohen pesë shoqëri të tjera që nuk kanë mundur të mbulojnë as 50% të kostos totale si: SHA UK Kukës (49.3%), SHA U Kurbin (48.7%), SHA UK Mallakastër (41.4%), SHA UK Rrogozhinë (34.9%) dhe SHA U Korçë Fshat (32.7%).




Figura 6. Mbulimi i kostos totale për grupin 2 në vitin 2012

Gjatë vitit 2012 ky tregues është përkeqësuar për 8 nga 20 shoqëritë e grupit të dytë. Rënien më të madhe e ka shënuar SHA UK Pogradec (-27.3%). Përkeqësimi i situatës në rastin e kësaj shoqërie ka ardhur si pasojë e kostove për shlyerjen e kredive të marra. Përkeqësim të këtij treguesi kanë pësuar edhe SHA UK Burrel (-13.3%) dhe SHA UK Krujë (-11.8%).

Nëse krahasojmë nivelin e këtij treguesi dhe ndryshimet e tij me vitin 2010, përmirësim i dukshëm është raportuar nga SHA UK Gjirokastrë (28.2%), SHA U Kurbin (22.5%), SHA U Tepelenë (20.7%) dhe SHA U Lushnjë Fshat (17.3%). Ndërsa shoqëritë që kanë regjistruar përkeqësim shumë të madh të këtij treguesi, krahasuar me vitin 2010, janë: SHA UK Krujë (-42.1%) dhe SHA UK Burrel (-32.6%).

Grupi i tretë i shoqërive:

Në këtë grup SHA U Malësi e Madhe rezulton si shoqëria që ka arritur mbi 100% në mbulimin e kostos totale. Nga analiza e të dhënave të raportuara ky përmirësim vjen si rrjedhojë e tarifave më të larta sesa ato të aplikuara gjatë vitit 2011 e njëkohësisht të pamiratuara nga ERRU. Po kështu SHA UK Himarë dhe SHA U Delvinë renditen në shoqëritë mbi nivelin e benchmarking prej 80% për performancë të mirë me përkatësisht 115.9% dhe 89.3% mbulim të kostos totale. Vetëm 7 nga 26 shoqëri të këtij grupi operojnë në kufirin e performancës së pranueshme me mbi 50% të mbulimit të kostos totale. SHA UK Pukë Fshat qëndron në skajin tjetër, duke mbuluar vetëm një përqindje të vogël të kostove totale (14.7%) me të ardhurat.




Figura 7. Mbulimi i kostos totale për grupin 3 në vitin 2012

Shoqëritë që kanë treguar ecuri negative gjatë vitit 2012 janë: SHA U Ura Vajgurore (-8.3%), SHA U Novoselë (-5.2%) dhe SHA U Peqin (-4.9%) të cilat kanë regjistruar rëniet më të mëdha në përqindjen e mbulimit të kostos totale. Numrohen 19 shoqëri UK që kanë arritur të përmirësojnë situatën e tyre, 5 nga të cilat në mënyrë domethënëse, me më tepër se 10%: SHA U Malësi e Madhe (65.3%), SHA UK Mirditë (15.7%), SHA U Delvinë (14.8%), SHA U Orikum (13.9%), SHA U Bulqizë (11.4%) dhe SHA U Bilisht (11.1%). Në grupin e tretë bëjnë pjesë shoqëri të vogla me situatë të vështirë financiare. Gjendja e tyre e vështirë vjen si rrjedhojë e: (i) mungesës së investimeve (nga njësitë e qeverisjes vendore apo qeverisjes qendrore), (ii) duke qenë të vogla nuk janë në vëmendjen e donatorëve, (iii) shtritje të madhe të zonës së shërbimit dhe numër të vogël konsumatorësh dhe (iv) menaxhim jo i mirë i burimeve njerëzore. Shumë nga shoqëritë e këtij grupi nuk kanë aplikuar asnjëherë për ndryshim tarife e një pjesë tjetër operojnë me tarifa të vendosura përpara shumë vitesh. ERRU do të vazhdojë përpjekjet për të inkurajuar këto shoqëri të aplikojnë për ndryshim tarifash.

Përfundime

Analiza tregon se edhe këtë vit rezultatet më të mira të mbulimit të kostos totale janë arritur nga shoqëritë më të mëdha ujësjellës kanalizime ndërsa shumë shoqëri të vogla vazhdojnë të varen nga burimet e jashtme financiare, me pak ose aspak të ardhura të mbetura për tu investuar. Në vitin 2012 niveli mesatar i mbulimit të kostos totale për sektorin është në nivelin 82.7% dhe është 3.3% më lart se vitin e kaluar. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhojë e: (i) rritjes së të ardhurave të tjera nga tarifa fikse, lidhje të reja, rilidhje etj; (ii) investimet e bëra në vitet e fundit kanë çuar në uljen e kostos nga amortizimi. Për vitin 2012 ky tregues shënon arritjen e objektivit të ERRU i cili është 80%. Amortizimi dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 26% të kostos totale ndërkohë që një vit më parë këto kosto zinin diçka më shumë rreth 27% të tyre. Ky përkeqësim i lehtë i strukturës së kostos vjen si rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve për mirëmbajtje si rezultat i investimeve të realizuara gjatë viteve të fundit.

Lidhur me këtë tregues SHA UK Tiranë (133%) SHA UK Gjirokastrë (122%) janë dy shoqëritë me nivelin më të lartë të mbulimit të kostove totale. Veçanërisht SHA Gjirokastrë po punon që me fondet e veta ta realizojë një pjesë të investimeve që nevojiten për të përmirësuar cilësinë e shërbimit si dhe eficiencën e shoqërisë. Gjithashtu SHA UK Pogradec, nëpërmjet menaxhimit të mirë ka sjellë përballimin e kostove të huamarrjes. Nga ana tjetër shoqëria ka rritur nivelin e të ardhurave nëpërmjet identifikimit dhe faturimit të të gjithë klientëve brenda zonës së shërbimit, gjë që është shoqëruar me përmirësime në cilësinë e shërbimeve (të tilla si p.sh furnizimi me ujë tani bëhet për 21 orë/ditë) dhe duke rritur ndërgjegjësimin e publikut për të paguar për shërbimet që ai merr.

3.3 Norma e Arkëtimit

Norma e arkëtimit është raporti i shumës së faturuar për shërbimet e ofruara dhe të ardhurave të mbledhura nga klientët. Në thelb, performanca e mirë në lidhje me normën e arkëtimit është funksion menaxherial. Norma mesatare e arkëtimit në sektorin ujësjellës-kanalizime, për vitin 2012, është 90.9% nga 79.9% që ishte një vit më parë, ka tejkaluar edhe objektivin strategjik të sektorit për vitin 2012 (88%) si edhe benchmarking për performancë të mirë prej 82% të ERRU për vitin 2012.

Grupi i parë i shoqërive:

Në grupin e parë, siç mund të shihet edhe nga grafiku, SHA UK Tiranë është në krye të listës së shoqërive pasi ka arritur të arkëtojë edhe shuma të faturuara në periudhat e mëparëshme që deri tani konsideroheshin si “debitore”. Po kështu SHA UK Fier, SHA UK Korçë dhe SHA U Elbasan Fshat janë shoqëritë që kanë pasur performancë të mirë për këtë tregues përkatësisht, me 91.2%, 88.9% dhe 95.2% duke tejkaluar të dy objektivat. Ndërkohë performanca më e dobët për këtë tregues në vitin 2012 është regjistruar nga SHA UK Shkodër (59.1%) ku norma e arkëtimit ka qenë nën vijën e kuqe.




Figura 8. Norma e arkëtimit për grupin 1 në vitin 2012

Shtatë nga dhjetë shoqëritë e këtij grupi kanë tendencë pozitive në normën e tyre të arkëtimit. Rritje në nivel më të lartë kanë regjistruar shoqëritë: SHA UK Tiranë me 22.8%, SHA UK Fier me 12.8% dhe SHA U Vlorë me 12.3%. Shoqëritë të cilat kanë pësuar rënie të këtij treguesi krahasuar me vitin paraardhës janë: SHA UK Berat-Kuçovë (-7.5%), SHA U Elbasan Fshat (-5.9%), SHA UK Korçë (-2.1%). Kryesisht në këto shoqëri arsyet e përkeqësimit të këtij treguesi janë vendosja në faturën e furnizimit me ujë e taksave lokale dhe rritja e tarifave në vitin 2012.

Gjatë periudhës 2010-2012, SHA UK Durrës ka treguar në mënyrë të vazhdueshme përmirësime të këtij treguesi, si rezultat i punës për përmirësimin e sistemit të faturimit dhe arkëtimit. Ky përmirësim është arritur nëpërmjet fushatave publicitare apo masave shtrënguese të tilla si: ndërprerjet e lidhjeve dhe ngritja e padive gjyqësore ndaj debitorëve. Në këtë mënyrë shoqëria ka arritur të rrisë normën e arkëtimit me 20.3% nga 2010 deri në 2012.

Grupi i dytë i shoqërive:

Shoqëritë që tregojnë se kanë ecuri të mirë me mbi 82% të normës së arkëtimit janë 10 nga 19 që bëjnë pjesë në grupin e dytë. SHA UK Lushnjë regjistron performancën më të mirë ku norma e arkëtimit është 94.4%. Vetëm 2 nga shoqëritë e këtij grupi janë pozicionuar nën vijën e kuqe me performancë të dobët në arkëtime; SHA UK Lushnjë Fshat (57.9%), dhe SHA U Kurbin (40.11%).




Figura 9. Norma e arkëtimit për grupin 2 në vitin 2012

Vihet re se ecuria e këtij treguesi për vitin 2012 është negative, 11 shoqëri kanë pësuar rënie të normës së arkëtimit. Shoqëria me ecurinë më pozitive që nga 2010 dhe me performancë brenda kufijve të mirë është SHA UK Krujë, me një përmirësim prej 15.0%. Nga 2010 deri në 2012, disa prej shoqërive kanë bërë regres të dukshëm në normën e tyre të arkëtimit. SHA U Kurbin ka regjistruar rënien më të madhe të këtij treguesi me (-20.7%), SHA U Lushnjë Fshat me (-19.5%), SHA UK Burrel me (-18.6%) dhe SHA U Tepelenë me (-16.0%).

Grupi i tretë i shoqërive:

Në grupin e tretë vetëm 8 shoqëri kanë normë arkëtimi më të madhe se 82%, që është objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU. 11 shoqëri janë në kufijtë e performancës së pranueshme, ndërsa 9 shoqëri të tjera arkëtojnë më pak se 60% të të ardhurave të tyre nga faturimi. Kështu, SHA U Divjake është shoqëria me performancën më të mirë, me një normë arkëtimi prej 108.5%. Ky rezultat ka ardhur si rrjedhojë e punës së mirë që është bërë për arkëtimin e debive nga periudhat e mëparshme. Ndërsa me performancën më të dobët vazhdon të jetë SHA U Tropojë me një normë prej 29.7%.




Figura 10. Norma e arkëtitimit për grupin 3 në vitin 2012

Gjatë viteve 2010 - 2011 ky tregues përgjithësisht ka pasur një ecure negative për të gjitha shoqëritë e grupit të tretë. Për shumicën e shoqërive, 17 nga 28 prej tyre, norma e arkëtitimit ka qenë më e ulët se një vit më parë. Tendencën më negative e ka raportuar SHA UK Peqin duke reduktuar normën e arkëtitimit me 25.5%. Po kështu rënie të fortë në nivelin e këtij treguesi kanë regjistruar shoqëritë SHA UK Rubik (-23.1%), SHA U Bulqizë (-20.1%), SHA UK Mirditë (-15.9%), SHA U Orikum (-13.9%) dhe SHA U Delvinë (-12.4%).

Nga ana tjetër disa shoqëri kanë bërë përmirësime të mëdha ku norma e arkëtitimit është rritur krahasuar me një vit më parë; SHA U Ura Vajgurore me 31.7%, SHA U Divjakë me 22.9%, SHA UK Krastë me 14.4% dhe SHA UK Bashkia Pukë me 12.3%. Po të shohim ecurinë nga viti 2010 në vitin 2012, SHA U Divjakë dhe SHA U Ura Vajgurore kanë raportuar përmirësim shumë të mirë, në rritjen e normës së arkëtitimit përkatësisht me 19.0% dhe 18.0%.

Përfundime

Vihet re se norma mesatare e arkëtimit në sektor është përmirësuar me 11 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Kjo tregon se shoqëritë kanë treguar vëmendje ndaj arkëtimit të të ardhurave të tyre. Disa nga arsyet e këtij përmirësimi shumë të mirë të këtij treguesi janë: (i) mbledhja e borxheve të vjetra të paarkëtuara në vite nga disa shoqëri; (ii) rritja e punës për të mirë administruar zonat e mbulimit nëpërmjet masave shtrënguese.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se shoqëritë duhet të përdorin të gjitha format e mundshme për të përmirësuar normën e arkëtimit: faturimi sistematik i të gjithë klientëve brenda zonës së tyre të juridiksion, krijimi i lehtësirave për kryerjen e pagesave duke hapur zyra të kujdesit ndaj klientit lehtësisht të arritshme, ofrimit të mënyrave bashkëkohore të kryerjes së pagesave, identifikimi i klientëve problematikë dhe gjithashtu futja në përdorim e arkëtimit të detyruar. Një ndikim pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi është ofrimi shërbimeve cilësore. Të dhënat tregojnë se shoqëritë që ofrojnë shërbime cilësore kanë edhe normë arkëtimi të lartë. Konsumatorët shprehën se nuk hezitojnë të paguajnë edhe me tarifa më të larta nëse marrin një shërbim cilësor. (Studimi mbi 'Perceptimin e Qytetarëve lidhur me Cilësinë e Shërbimeve Ujësjellës Kanalizime' (2011).

3.4 Eficiencia e Stafit

Një nga objektivat kryesor të funksionit të ERRU është ofrimi i shërbimit në standartet më të larta dhe për këtë nevojitet që shoqëritë të përmirësojnë eficiencën operacionale. Eficiencia e stafit është treguesi që na lejon të kuptojmë se si janë menaxhuar burimet njerzore për të rritur eficiencën e përgjithshme të shoqërisë. Duke qenë se kostoja e personelit për momentin zë një përqindje të madhe të kostove të O&M të shoqërive ujësjellës kanalizime (mesatarisht 31% të kostove totale të shoqërive), ky tregues merr rëndësi të veçantë prandaj edhe është përfshirë në listën e KPI-ve që duhen analizuar.

Grupi i parë i shoqërive:

Objektivi i këtij treguesi nga ERRU për grupin e parë është 4 - 6 punonjës për 1000 lidhje. Në vitin 2012 rezultoi se mesatarja e këtij treguesi për këtë grup është gati 6 punonjës për 1000 lidhje duke qenë brenda objektivit të ERRU. Vetëm dy shoqëri e kanë arritur objektivin e performancës së mirë (më pak se 4) të cilat janë: SHA UK Korçë dhe SHA UK Tiranë me përkatësisht 2.3 dhe 3.6 punonjës për 1000 lidhje. Ndërkohë, SHA U Elbasan Fshat, vazhdon të mbetet shoqëria me treguesin më të dobët me 12.8 punonjës për 1000 lidhje gati 6 herë më e lartë sesa shoqëria më e mirë në këtë grup.




Figura 11. Eficiencia e stafit për grupin e parë në vitin 2012

Eficiencia e stafit në grupin e parë vazhdon të mbetet pothuajse në të njëjtat nivele nga viti në vit. Në 2012 regjistroi ndryshime fare të lehta qofshin këto pozitive apo negative kundrejt vitit 2011, ndërkohë që për këtë grup mesatarisht numërohet i njëjti numër punonjësish si ai i vitit 2009. Përveç SHA UK Fier, ku ky tregues ka pësuar rritjen më të madhe me 1.5 punonjës për 1000 lidhje.

Grupi i dytë i shoqërive:

Objektivi i këtij treguesi nga ERRU për grupin e dytë është 6 - 10 punonjës për 1000 lidhje. Në vitin 2012 rezultoi se mesatarja e këtij treguesi për këtë grup është gati 10.32 punonjës për 1000 lidhje duke qenë jashtë objektivit të ERRU. Edhe ky grup ka ruajtur pothuajse të njëjtin numër punonjës për 1000 sikurse në vitin 2011 dhe 2010. SHA UK Lushnjë Fshat ka përmirësuar regjistrin e konsumatorëve duke shtuar të gjithë klientët aktualë të zonës së shërbimit. Në këtë mënyrë raporti punonjës për 1000 lidhje jep më saktë nivelin e këtij treguesi. Në raportimin e ardhshëm pritet që analiza e treguesve për këtë shoqëri të jetë edhe më reale, e për rrjedhojë edhe mesatarja e grupit të marrë kuptim.




Figura 12. Eficienca e stafti për grupin e dytë në vitin 2012

SHA UK Sarandë është shoqëria me performancën më të mirë në grupin e dytë, e cila operon me 3.2 punonjës për 1000 lidhje, e ndjekur nga SHA UK Pogradec me 4.6 punonjës për 1000 lidhje, SHA UK Lezhë dhe SHA Rrogozhinë. Në fund të listës renditet SHA U Patos me performancën më të dobët në këtë grup me 25.5 punonjës për 1000 lidhje. Brenda kufijve të performancës së pranueshme që për grupin 2 varion nga 6 deri në 10 punonjës/1000 lidhje, operojnë 7 nga 21 shoqëri.

Ecurinë më negative e kanë shënuar SHA UK Burrel dhe SHA U Kurbin ku janë punësuar më shumë punonjës për 1000 lidhje përkatesisht 1.3 dhe 1.2.

Grupi i tretë i shoqërive:

Objektivi i këtij treguesi nga ERRU për grupin e tretë është 10 - 15 punonjës për 1000 lidhje. Në vitin 2012 rezulton se mesatarja e këtij treguesi për këtë grup është gati 16 punonjës për 1000 lidhje duke qenë larg objektivit të ERRU. Ky grup veçanërisht dallohet për përmirësimin e vazhdueshëm të këtij treguesi nga viti në vit. Edhe pse përmirësimet janë të lehta ato janë të rëndësishme duke pasur parasysh peshën e kostos së personelit në totalin e kostos. Pra ndryshime të vogla të personelit japin një impakt në përmirësimin e situatës financiare të shoqërive, duke mbuluar më mirë kostot e shoqërive. Nga ana tjetër përmirësimi i këtij treguesi përmirëson edhe menaxhimin e shoqërisë.

Vetëm 10 shoqëri të këtij grupi kanë më pak se 10 punonjës për 1000 lidhje dhe performuesi më i mirë është SHA UK Libohovë dhe Ersekë me diçka më shumë sesa 5 punonjës për 1000 lidhje. Në po këtë kategori listohen shoqëritë SHA UK Himarë, Selenicë, Delvinë, Fushë Krujë, Fushë Arrëz, Orikum dhe Pukë. Gjendje problematike paraqesin SHA U Gjirokastrë Fshat, SHA U Shkodër Fshat dhe SHA UK Pukë Fshat përkatësisht me 43.1, 36.3 dhe 31.6 punonjës për 1000 lidhje, ku numri i punonjësve në këto shoqëri është 7-8 herë më i lartë sesa ai i shoqërisë më të mirë në këtë grup.




Figura 13. Efienca e stafit për grupin 3 në vitin 2012

Sikurse në rastin e SHA UK Lushnjë Fshat në grupin e dytë, edhe në këtë grup evidentohen raste ku treguesi nuk është llogaritur qartë dhe këto janë shoqëri (që kanë edhe numrin më të lartë të stafit për 1000 lidhje) të cilat operojnë kryesisht në zona rurale. Për ERRU një raportim më i drejtë në lidhje me numrin e klientëve brenda zonës së shërbimit do të eliminonte deformimin e të dhënave dhe treguesve.

Përfundime

Nga analiza e të tre grupeve vihet re se vetëm 16 nga 57 shoqëri kanë arritur objektivin e performancës së mirë të vendosur për grupet e tyre përkatëse, ndërsa pjesa tjetër e shoqërive kanë nevojë të rrisin në mënyrë të konsiderueshme përpjekjet e tyre për përmirësimin e eficiencës së stafit. Meqënëse kosto e punës është një nga zërat kryesor dhe me peshë të madhe në kostot O&M dhe atë totale, përmirësimi i eficiencës së stafit do të shërbente si element thelbësor në përmirësimin e eficiencës operacionale, si rrjedhim shoqëritë do të shkojnë drejt arritjes së objektivit strategjik të sektorit që është qëndrueshmëria financiare. Ndër shqetësimet kryesore të ERRU janë mbipunësimi dhe nivelet e ulëta të produktivitetit të punonjësve. Për të nxitur shoqëritë që të rrisin produktivitetin e stafit të tyre, nëpërmjet treguesit të eficiencës së stafit, ERRU do të vendosi tregues të detajuar për secilën nga shoqëritë UK si pjesë e procesit të ndryshimit të tarifave. Arritja e objektivave të performancës lidhur me këtë tregues qëndron në optimizimin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar, të motivuar dhe të dedikuar, përcaktimin e procedurave të brendshme operacionale, delegimin e detyrave dhe përgjegjësi dhe zgjerimin e bazës së klientëve.

Shoqëritë e mëdha arrijnë më lehtë nivele të larta të eficiencës së stafit sesa shoqëritë më të vogla ose ato që furnizojnë sipërfaqe të gjera rurale. Mungesa e eficiencës mund të përbëjë një argument për rajonalizimin e operatorëve të shërbimit. Gjithësesi analiza e mësipërme provon se edhe sistemet më të vogla mund të performojnë si duhet kur kanë një menaxhim të mirë.

ERRU mbështet hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit dhe certifikimit për stafin dhe Keshillat Mbikqyrese të shoqërive në kuader të zbatimit të strategjisë sektoriale si një hap i rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve menaxhuese. Certifikimi do të jetë një proces i vazhdueshëm për të siguruar që individët t'i ruajnë të qëndrueshme njohuritë e fituara. Për këtë arsye janë përgatitur nëpërmjet një bashkëpunimi trepalësh ndërmjet ERRU, GIZ dhe USAID manuali refererues dhe modulet e trajnimit.

3.5 Uji pa të Ardhura

Ajo pjesë e ujit të prodhuar, e shprehur në përqindje, që nuk gjeneron të ardhura përkufizohet si “Ujë pa të ardhura”. Ky përkufizim përfshin si humbjet reale të ujit për arsye teknike (p.sh rrjedhjet në sistemin e shpërndarjes apo në depo) ashtu edhe ato komerciale, që i referohen sasisë së ujit që në fakt shkon tek konsumatori, por që nuk gjeneron të ardhura si rezultat i konsumit të pa ligjshëm, pasaktësive në matjen e prodhimit dhe konsumit si dhe gabimeve në menaxhimin e të dhënave.

Gjatë vitit 2012, prodhimi total i ujit për 57 shoqëri ujësjellës në Shqipëri ishte 279,912 m³, ndërsa sasia e ujit të shitur ishte vetëm 92,965 m³. Këto të dhëna tregojnë se mesatarja e ujit pa të ardhura në sektor për vitin 2012 është 67.1%. Niveli i këtij treguesi vazhdon të jetë më i lartë se benchmarking i performancës së dobët (30 - 50%) i përcaktuar nga ERRU por edhe më i lartë se objektivi strategjik për vitin 2012 prej 57%.

Grupi i parë i shoqërive:

Siç vihet re edhe nga grafiku, në grupin e parë vetëm SHA UK Korçë ka nivelin më të ulët të këtij treguesi 30.7% duke qene keshtu edhe shumë pranë nivelin për performancë të mirë. Gjithashtu SHA U Elbasan Fshat dhe SHA UK Kavajë renditen brenda nivelit të pranuar të benchmarking për ujin pa të ardhura përkatësisht me 36.1% dhe 39.8%. Shoqëria me performancën më të dobët ku uji pa të ardhura ka arritur nivelin dramatik gati 85%% është SHA UK Berat Kuçovë. Për 7 nga 10 shoqëritë e këtij grupi, uji pa të ardhura është mbi benchmarking prej 50% gjë që tregon një nivel shumë të dobët të performancës dhe nevojë të menjëhershme për përmirësime.




Figura 14. Uji pa të ardhura për grupin 1 në vitin 2012

Nëse krahasojmë ecurinë e këtij treguesi për vitet 2010 – 2012, shoqëritë SHA U Vlorë dhe Elber shpk kanë bërë progres duke reduktuar nivelin e ujit pa të ardhura përkatësisht me -6.1 pikë përqindjeje dhe -3.6 pikë përqindjeje. Nga ana tjetër, ecuria më negative gjatë kësaj periudhe është vënë re në SHA UK Shkodër (+11.1%), SHA UK Tirane (+10.8%) dhe SHA UK Kavajë (+10.5%).

Grupi i dytë i shoqërive:

Në grupin e dytë, pjesa më e madhe e shoqërive kanë regjistruar nivele shumë të larta të ujit pa të ardhura. SHA UK Rrogozhinë (19.8%), SHA UK Librazhd (23.1%) dhe SHA UK Kukës (24.6%) dhe SHA U Korçë Fshat (29.5%) janë performuesit më të mirë. Këto shoqëri kanë arritur të mbeten në zonën e performancës së mirë për tre vitet e fundit, duke e mbajtur nivelin e ujit pa të ardhura nën 30%. Ndërsa SHA UK Sarandë ka nivelin më të lartë të ujit pa të ardhura për vitin 2012, me 76.2%. Edhe pse me ndonjë përmirësim të vogël, 8 nga 19 shoqëri të këtij grupi kanë treguar performancë të dobët për 3 vite radhazi lidhur me këtë tregues me një nivel mbi 50% të ujit pa të ardhura.




Figura 15. Uji pa të ardhura për grupin 2 në vitin 2012

SHA U Patos është shoqëria me përmirësimin më të madh të këtij treguesi ku uji pa të ardhura është reduktuar me 14.8%. Po kështu ecuria pozitive gjatë vitit 2012, kanë treguar edhe SHA UK Pogradec (-8.9%) dhe SHA UK Rrogozhinë (-5.7%). SHA UK Pogradec renditet ndër performuesit më të mirë duke përmirësuar këtë tregues për disa vite rradhazi. Krahësuar me vitin 2010 kjo shoqëri ka reduktuar ujin pa të ardhura me (-18.4%), ndjekur nga SHA U Korçë Fshat me (-16.4%) dhe SHA U Patos me (-16.2%).

Gjithësesi, duhet patur parasysh se niveli i ulët i matjes (veçanërisht për shoqëritë me më pak se 5%) dhe faturimi aforfe rrisin probabilitetin për gabime. Lidhur me arritjet e SHA UK Pogradec mund të flasim me më shumë besueshmëri pasi niveli i matjes për këtë shoqëri është i lartë (91.7%), që do të thotë se shifrat e ujit pa të ardhura janë të bazuara në matje reale. Reduktimi i humbjeve ka ardhur si rezultat i kombinimit të investimeve për rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë, instalimit të matësve në prodhim dhe për konsumatorë individual, ndërprerjes së lidhjeve të paligjshme dhe përmirësimit të sistemit të faturimit. Por nuk mund të themi të njëjtën gjë për SHA U Patos apo edhe shoqëri të tjera ku i gjithë shërbimi është i pamatur.

Grupi i tretë i shoqërive:

Më shumë se gjysma e shoqërive në grupin e tretë humbin mbi 50% të ujit të prodhuar duke raportuar kështu performancë TV dobët për sa i përket këtij treguesi. 6 nga 28 shoqëri të këtij grupi renditen mbi nivelin e performancës së mirë prej 30% ujë pa të ardhura. Sipas raportimit të vetë shoqërisë rezulton se SHA UK Himarë në lidhje me nivelin e prodhuar dhe faturuar të ujit për vitin 2012 regjistron nivelin më të ulët të ujit pa të ardhura 2.9%. Vëllimi i prodhuar dhe ai i faturuar janë raportuar thuajse në vlera të barabarta. Shoqëria pohon se sasia e ujit të prodhuar dhe faturuar nuk matet rrjedhimisht dhe uji pa të ardhura është i vlerësuar dhe jo i përlogaritur në mënyrë të saktë. Performuesi më i dobët jo vetëm i grupit, por edhe në përgjithësi është SHA U Këlcyrë ku niveli i ujit pa të ardhura arrin 85.4%. Kjo shoqëri vazhdon të ketë nivel të lartë të ujit pa të ardhura prej disa vitesh.




Figura 16. Uji pa të ardhura për grupin 3 në vitin 2012

Në grupin 3, ndër shoqëritë që kanë regjistruar rritje domethënëse të nivelit të ujit pa të ardhura mund të përmendim: SHA UK Fushë Arrëz (+42.5%), SHA U Malësi e Madhe (+35.2%), SHA UK Pukë (+28.1%), SHA U Novosel (+20.9%) dhe SHA UK Rubik (+15.9%). Krahësuar me vitin 2010, SHA U Malësi e Madhe është shoqëria që ka regjistruar rritjen më të madhe të ujit pa të ardhura (+28.9%).

Nga ana tjetër, shoqëritë që kanë arritur të zvogëlojnë në mënyrë të konsiderueshme ujin pa të ardhura gjatë vitit 2012 janë: SHA U Gjirokastrë Fshat (-21.7%), SHA UK Libohovë (-16.4%), SHA U Vau i Dejës (-8.3%) dhe SHA U Ura Vajgurore (-5.6%).

Përfundime

Niveli prej 67.1% i ujit pa të ardhura për të gjithë sektorin jo vetëm sjell një përkeqësim të situatës tejet problematike e cila e gjitha klasifikohet si me performancë të dobët. Nga analiza e performancës së ujit pa të ardhura vihet re se 33 shoqëri operojnë në kushtet ku mbi 50% e ujit të prodhuar nuk faturohet. E përkthyer në kosto, kjo shifër ngre alarmin për marrjen e masave urgjente për zvogëlimin e humbjeve dhe të shpenzimeve të panevojshme që lindin nga mbiprodhimi. Edhe pse besueshmëria e të dhënave nuk është optimale, shifrat tregojnë se shoqërive u duhet të punojnë dhe të fokusohen në përmirësimin e këtij treguesi si një faktor i rëndësishëm për arritjen e qëndrueshmërisë financiare.

Bazuar në eksperiencën e shoqërive me performancën më të mirë, programet e investimit për zëvendësimin në shkallë të gjerë të infrastrukturës së vjetruar nuk janë e vetmja pikë nga ku fillon reduktimi i ujit pa të ardhura. Për ato shoqëri ku mungon matja e prodhimit është e vështirë të hartojnë bilancin e ujit me shifra të sakta e për rrjedhojë edhe niveli i ujit pa të ardhura bëhet një tregues i vlerësuar. Identifikimi, ndërprerja ose legalizimi i lidhjeve të paligjshme do të përbënte një hap të parë për përmirësimin e situatës por nga ana tjetër do të ndihmonte edhe në rritjen e nivelit të të ardhura. ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve. Operatorët duhet të kenë plane të qarta veprimi përsa i përket angazhimeve konkrete për reduktimin e humbjeve të ujit.

ERRU është i vetëdijshëm se zvogëlimi dhe kontrolli i ujit pa të ardhura është proces kompleks që kërkon kohë. Nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese afatgjata, pjesëmarrjes aktive në hartimin e politikave, strategjive të investimit e legjisllacionit dhe nxitjes për respektimin e standarteve teknike rregullatori do të mbështesë shoqëritë në trajtimin e humbjeve.

3.6 Niveli i Matjes

Përqindja e lidhjeve me matës kundrejt numrit total të lidhjeve është treguesi që shpreh nivelin e matjes. Ecuria e këtij treguesi për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive duke e rritur nivelin mesatar në 55.1% për vitin 2012 nga 50.6% që ishte një vit më parë. Në bazë të Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017 objektivi i këtij treguesi për vitin 2012 prej 52% është tejkaluar, duke treguar punën e mirë që shoqëritë kanë bërë për përmirësimin e këtij treguesi. Megjithatë mbetet ende punë për tu bërë në këtë drejtim pasi objektivi për të gjitha shoqëritë në vend i vendosur nga ERRU është 85%.

Grupi i parë i shoqërive:

SHA UK Korçë vazhdon të jetë e vetmja shoqëri në grupin e parë që ofron 100% shërbim të matur duke qenë kështu edhe performuesi më i mirë. SHA UK Kavajë ka mundur ta përmirësojë këtë tregues si dhe të operoj mbi kufirin e benchmarking për performancë të mirë me 86% të lidhjeve me matës. Shoqëria me shkallën më të ulët të shërbimit të matur, mbetet SHA UK Shkodër me vetëm 8%, pavarësisht një përmirësimi të lehtë të këtij treguesi në vitin 2012 krahasuar me vitin e kaluar.




Figura 17. Niveli i matjes për grupin 1 në vitin 2012

Të gjitha shoqëritë e këtij grupi (përveç SHA UK Durrës) kanë pasur ecuri pozitive të këtij treguesi duke rritur nivelin e matjes, edhe pse në disa raste me përmirësime shumë të vogla. Ecuria më pozitive është shënuar nga SHA UK Fier, e cila në vitin 2012 e ka rritur këtë tregues me 27.9%. Shoqëria është në fazën përfundimtare të instalimit të matësive të dixhitalizuara. Puna ka ecur me ritme të kënaqshme dhe brenda pak kohësh shoqëria do të ofrojë shërbim 100% të matur. Gjithashtu është për t'u vlerësuar progresi i shoqërive SHA UK Vlorë (9.0%) dhe SHA U Elbasan Fshat (7.1%). Për SHA UK Durrës numri i lidhjeve me matës ka mbetur thuajse në të njëjtin nivel me një rënie fare të vogël kahësuar me një vit më parë.

Grupi i dytë i shoqërive:

Vetëm 3 shoqëri në grupin e dytë, kanë tejkaluar kufirin e performancës së mirë prej 85% në vitin 2012: SHA U Lushnjë Fshat (100%), SHA UK Librazhd (96.3%) dhe SHA UK Pogradec (91.7%). Të dhënat për SHA U Lushnjë Fshat nuk kanë bazë krahasimi për ecurinë e këtij treguesi kundrejt viteve të kaluara si edhe kundrejt shoqërive të tjera. Në vitin 2011 kjo shoqëri ia transferoi shitjen e mëtejshme të ujit komunave në zonën e saj të mbulimit. Në këtë mënyrë kjo shoqëri ka matur vetëm pjesën që u shet komunave dhe jo konsumatorëve finalë. SHA UK Gjirokastër, SHA UKurbin dhe SHA U Patos, kanë pasur performancë shumë të dobët lidhur me shërbimin e matur, me pak se 1%.




Figura 18. Niveli i matjes për grupin 2 në vitin 2012

Niveli i matjes është thujtë i njëjtë për shumicën e shoqërive në këtë grup. SHA UK Burrel dhe SHA UK Sarandë kanë bërë pak progres në lidhje me këtë tregues duke e rritur nivelin e matjes me përkatësisht (+6.4%) dhe (+4.5%) krasahuar me vitin 2011. Ndërsa rënie të këtij treguesi kanë raportuar shoqëritë SHA UK Lushnjë (-6.3%), SHA UK Krujë (-4.2%) dhe SHA UK Pogradec (-3.3%).

Grupi i tretë i shoqërive:

Në grupin e tretë, shërbimi i matur është në nivelet më të ulta të mundshme. Vetëm SHA U Divjakë raporton 100% shërbim të matur ndërsa 25 nga 28 shoqëri kanë më pak se 50% të lidhjeve të tyre me matës. Gjatë vitit 2012 për 7 shoqëri SHA U Gjirokastrë Fshat, SHA U Çorovodë, SHA U Malësi e Madhe, SHA UK Libohovë, SHA U Orikum, SHA U Tropojë dhe SHA UK Krastë) niveli i matjes ka qenë nën 1%.




Figura 19. Niveli i matjes për grupin 3 në vitin 2012

Tendenca më pozitive është vënë re në shoqërinë SHA UK Pukë e cila ka rritur nivelin e matjes me 11.6%. Po kështu kanë bërë përmirësim të këtij treguesi me më shumë se 5%, SHA UK Peqin (+8.8%), SHA UK Ersekë (+8.5%) dhe SHA U Ura Vajgurore (+5.7%). Krahësuar me vitin 2010, 3 shoqëri kanë rritur shkallën e matjes me më shumë se 10% janë: SHA UK Pukë (+23.5%), SHA UK Mirditë (+18.9%) dhe SHA UK Erseke (+10.1%) ndërsa për SHA UK Fushë Krujë (-17.4%) dhe SHA U Shkodër Fshat (-6.5%) ky tregues ka patur tendencë negative.

Përfundime

Vihet re se dy grupet e para (grupi I dhe grupi II) kanë një nivel mesatar pothuajse të njëjtë të matjes së ujit mbi 50%. Grupi i tretë ka një nivel mesatar të matjes prej 23%, pothuajse sa gjysma e dy grupeve të para. Në të dy grupet e para ka shoqëri që e masin tërësisht ujin e shitur tek konsumatorët, sikurse ka shoqëri në grupin e tretë dhe të dytë që pothuajse nuk e masin fare këtë shërbim. Edhe pse një pjesë e shoqërive operojnë mbi nivelin e performancës së mire përse i përket shërbimit të matur, për të arritur objektivat afat-gjata të përcaktuara nga qeveria shumë shoqëri kanë akoma rrugë për të bërë. Kryesisht janë shoqëritë e vogla të cilat paraqesin nivele shumë të ulta të matjes së shërbimit.

Gjithashtu zëvendësimi i faturimit me tarifave të sheshta / aforfe bazuar në konsumin e vlerësuar me faturimin real volumetrik do të ulte nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive. Konsumatorët po fillojnë të kuptojnë avantazhin e matjes së konsumit pasi kështu janë në gjendje të vlerësojnë dhe kontrollojnë shpenzimet e tyre.

ERRU gjatë vitit 2012 në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësave. Operatorët kanë patur detyrim (bazuar në dy vendimet e Këshillit të Ministrave) që deri në fund të vitit 2010 të kishin përfunduar instalimet e matësave për të gjithë klientët jo familjarë dhe objektivi për të ardhmen është që të pajisen me matësa dhe klientë familjare. Por kjo nuk është realizuar pasi në nivel sektori ende 14,976 klientë jo familjarë nga 57,352 që janë gjithsej nuk janë të pajisur me matësa. Vlen të theksohet se 13 shoqëri (SHA UK Delvinë, SHA U Divjakë, SHA UK Fushë Krujë, SHA UK Kavajë, SHA UK Korçë, SHA U Korçë Fshat, SHA UK Librazhd, SHA U Lushnjë Fshat, SHA U Përmet, SHA UK Pogradec, SHA UK Pukë, SHA UK Rubik dhe SHA U Vau I Dejes) kanë përfunduar instalimin e matësave për të gjitha lidhjet privat/biznese. Gjithashtu, ERRU ka marrë masa për të reduktuar nivelet e larta të shërbimit të pa matur duke kërkuar instalimin e matësve për të gjitha lidhjet e reja.

3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Konsumatorët reagojnë më shpejt kundrejt kohëzgjatjes së furnizimit me ujë dhe cilësisë së tij. Kur këta dy tregues arrijnë në nivelin e standarteve të kërkuara, konsumatorët nuk do të kërkojnë burime të tjera furnizimi. Çdo përmirësim në secilin prej tyre do të vihet re dhe mirëpritet nga konsumatorët. Për vlerësimin e këtij treguesi është përdorur mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë e cila për vitin 2012 është 10.8 ore/ditë, thuajse e njëjtë me një vit më parë. Objektivi i performancës së mirë nga ERRU është 18 orë në ditë.

Grupi i parë i shoqërive:

Shoqëritë e grupit të parë ofrojnë mesatarisht 14.2 orë ujë në ditë duke e përmirësuar këtë shërbim me rreth 1 orë. E vetmja shoqëri që ofron 24-orë furnizim me ujë në grupin e parë është SHA UK Korçë. Mbi nivelin e performancës së mirë qëndrojnë edhe SHA UK Shkodër e SHA UK Fier të cilat ofrojnë përkatësisht 21 dhe 19.3 orë në ditë. Të gjitha shoqëritë në këtë grup ofrojnë furnizim me ujë më shumë se 8.0 orë, përveç SHA UK Durrës që furnizon me 6.2 orë në ditë duke mbetur nën kufirin e performancës së dobët.




Figura 20. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 1 në vitin 2012

Ecuria e këtij treguesi ka qenë pozitiv gjatë viti 2012 pasi 7 nga 10 shoqëritë të grupit të parë kanë bërë përmirësim në rritjen e orëve të furnizimit me shërbim. Krahësimi me vitin 2010 SHA UK Berat Kuçovë ka rregjistruar përmirësimin më të madh me 2.8 orë në ditë dhe SHA U Vlorë me 1.2 orë në ditë më shumë. Për shoqëritë e tjera ndryshimi ka qenë fare i vogël.

Grupi i dytë i shoqërive:

Shoqëritë e grupit të dytë ofrojnë mesatarisht 11.3 orë ujë në ditë duke ruajtur të njëjtin nivel me një vit më parë. 5 nga 19 shoqëri kanë arritur nivelin e performancës së mirë për sa i përket furnizimit të vazhdueshëm: SHA UK Librazhd, SHA UK Pogradec, SHA UK Lezhë, SHA U Gramsh dhe SHA U Tepelenë. SHA UK Librazhd është performuesi më i mirë me 24 orë në ditë shërbim të ofruar. Gjithashtu kjo shoqëri regjistron edhe rritjen më të madhe të këtij treguesi për vitin 2012 me 6.2 orë në ditë më shumë. Për 8 shoqëri, niveli i këtij treguesi është nën kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë): SHA Lushnjë Fshat, SHA UK Krujë, SHA UK Lushnjë, SHA U Peshkopi, SHA U Kurbin, SHA UK Sarandë, SHA U Patos, dhe SHA UK Gjirokastrë. Performuesi më i keq në këtë grup është SHA UK Gjirokastrë, ku konsumatorët furnizohen me vetëm 2.8 orë ujë në ditë.




Figura 21. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 2 në vitin 2012

Orët e furnizimit janë ulur ndjeshëm për shoqëritë SHA U Patos (-3.6 orë/ ditë), SHA UK Kukës (-2.8 orë/ditë) SHA U Korçë Fshat (-1.3 orë/ditë) dhe SHA UK Burrel (-1.2 orë/ditë). Ndërsa në rastin e SHA UK Mallakastër, SHA U Lushnjë Fshat dhe SHA Përmet ky tregues ka patur ecure pozitive duke shtuar numrin e orëve të furnizimit në ditë përkatësisht me 2.1 orë, 1.8 orë dhe 1.3 orë më shumë se një vit më parë. Krahasuar me vitin 2010 ecuria e furnizimit me ujë për shoqëritë e grupit të dytë ka qenë negative.

Grupi i tretë i shoqërive:

Shoqëritë e grupit të tretë ofrojnë mesatarisht 9.3 orë ujë në ditë duke ruajtur të njëjtin nivel me një vit më parë. Në këtë grup bëjnë pjesë shoqëritë që ofrojnë mesatarisht nivelin më të ulët të orëve të furnizimit në ditë.

SHA UK Rubik vazhdon të jetë performuesi më i mirë i këtij grupi me 21.8 orë në ditë sikurse më të mirët e grupeve 1 dhe 2. Në kufijtë e performancës së pranueshme janë 15 shoqëri me orare furnizimi prej 8 dhe 18 orë në ditë. Edhe pse ka bërë pak përmirësim përse i përket orëve të furnizimit me ujë SHA UK Krastë është shoqëria me performancën më të dobët me vetëm 4.2 orë në ditë.




Figura 22. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 3 në vitin 2012

SHA U Tropojë dhe SHA U Bilisht kanë raportuar rritjen më të madhe në orët e furnizimit përkatisht me (2.7 orë/ditë) dhe (1.0 orë/ditë). E kundërta ka ndodhur me katër shoqëri të tjera që kanë regjistruar përqësime të dukshme lidhur me këtë tregues sic janë SHA UK Peqin (-5.6 orë/ditë), SHA U Selenicë (-2.2 orë/ditë), SHA U Malësi e Madhe (-1.6 orë/ditë) dhe SHA UK Ersekë (-1.3 orë/ditë). Për këto shoqëri, sistemi i vjetruar i furnizimit është përqësuar edhe më shumë nga mungesa e investimeve dhe menaxhimi i dobët. Krahësuar me vitin 2010, SHA U Tropojë ka rritur orët e furnizimit me 3.1 orë/ditë. Ndërsa SHA UK Ersekë ka regjistruar rënien më të madhe të këtij treguesi me -4.7 orë/ditë.

Përfundime

Gjate vitit 2012 konsumatorët Shqiptarë janë furnizuar mesatarisht me 10.8 orë ujë në ditë. Niveli i këtij treguesi ka mbetur i njëjtë me një vit më parë dhe vazhdon të jetë nën nivelin e objektivit strategjik për këtë vit prej 13 orë në ditë si dhe nën nivelin e benchmarking për performancë të mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë në ditë. Problemin e furnizimit me ujë konsumatorët janë përpjekur ta zgjidhin me burime alternative. Shoqëritë për rrjedhojë nuk mund të vlerësojnë sasinë reale të nevojshme për konsum. Nga analiza e të tre grupeve vihet re se klientët e disa shoqërive janë përballur me ulje në orët furnizimit gjatë vitit 2012. Mungesa e shërbimit do t'i çonte konsumatorët, kryesisht ata të mëdhenj (privatë), drejt gjetjes së formave të tjera të furnizimit. Në këtë mënyrë shoqëria do të përballej me pasoja serioze sic janë humbja e klientëve potencial dhe ulja e të ardhurave. ERRU inkurajon shoqëritë në përpjekjet e tyre për të rritur qëndrueshmërinë për sa i përket ofrimit të shërbimit. Eksperienca e shoqërive me performancë të mirë në të tre grupet tregon se arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm nga investimet por mund të arrihet edhe nëse menaxhohet me profesionalizëm.

Përmirësimi i shërbimit për konsumatorët është një nga prioritetet e ERRU. Të dy treguesit e vendosur aktualisht për vlerësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, kohëzgjatja e furnizimit me ujë dhe cilësia e ujit të pijshëm janë tregues të lidhur me ndryshimin e tarifave. ERRU ka vendosur objektiva mbi performancën e operatorëve për këta tregues dhe më pas monitoron ecurinë për objektivat e vendosur.

ERRU do t'ju kërkojë operatorëve të përfishijnë keto objektiva në planet e tyre të biznesit për të gjetur rrugët dhe mundësitë për përmirësime të mëtejshme.

3.8 Cilësia e Ujit të Pijshëm

Treguesi i cilësisë së ujit të pijshëm merr në analizë: (i) testet e koliformit dhe (ii) klorit mbetës, dy të dhëna që masin standartin e ujit cilësisht të pijshëm. Këto analiza të ujit të pijshëm janë standarte sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe direktivat e Bashkimit Europian (BE) të cilat zbatohen nga Instituti i Shëndetit Publik. ERRU merr të dhëna në lidhje me këta tregues të ujit të pijshëm nga raportimet e shoqërive dhe nga ISHP.

ISHP nëpërmjet Drejtorive Rajonale në 51 bashki dhe komuna në të gjithë vendin është përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm në këtë sektor. Këta të fundit, marrin kampione në pika të ndryshme të zonës së shërbimit të operatorit dhe bëjnë testimin e parametrave të përcaktuara prej tyre. Në rastin kur cilësia e ujit të pijshëm nuk rezulton në nivele të pranueshme, DSHP monitoron shoqërinë deri në zgjidhjen e situatës dhe merr masat që konsumatorët të marrin informacion të menjëhershëm lidhur me situatën. ISHP është institucioni kryesor përgjegjës për mbledhjen e të dhënave nga këto drejtori.

Për të kryer analizën e këtij treguesi, ERRU ka në fokus dy parametra kryesor të cilët bëjnë të mundur të kemi një konsumator të mbrojtur dhe njëkohësisht “ujë cilësisht të pijshëm” sipas standarteve shtetërore të vendosura. Çdo papajtueshmëri me standartet bakteorologjike dhe klorin mbetës, përbën rrezik për shëndetin publik dhe ul besimin e konsumatorëve.

Mungesa e baktereve koliforme rikonfirmon sigurinë e përgjithshme mikrobiologjike të ujit të pijshëm për publikun ndërsa nivelet përkatëse të klorit mbetës tregojnë që uji mbetet i mbrojtur në mënyrë të përshtatshme gjatë shpërndarjes dhe depozitimit. Për të bërë këtë vlerësim, ERRU ka vendosur që nivelet e ulëta e të larta, të performancës së dobët dhe të pranueshme, të jenë përkatësisht 95% dhe 90%.

Analiza e performancës së paraqitur më poshtë bazohet mbi të dhënat e raportuara në Njësinë e Monitorimit dhe Benchmarking (NJMB). Këto të dhëna janë verifikuar edhe me të dhëna nga burime të tjera. Informacioni që ERRU merr nga ISHP nëpërmjet “Buletinit të Ujit të pijshëm” tregon se disa prej shoqërive⁶ kanë shumë pika të ndotura madje edhe të përsëritura nga muaji në muaj.

Grupi i parë i shoqërive:

Të dhënat në vitin 2012 për këtë grup, tregojnë që ky tregues qëndron pothuajse në të njejtat nivele me vitin 2011. Shoqëritë Elber shpk, SHA UK Korçë, SHA UK Shkodër kanë arritur një normë 100% të klorit mbetës dhe bakteret koliforme.




Figura 23. Cilësia e ujit të pijshëm për grupin 1 në vitin 2012

Shoqëria SHA U Vlorë me punën e bërë gjatë dy viteve të fundit ka përmirësuar ndjeshëm performancën e saj duke arritur normën e lejuar të sigurisë së klorit mbetës dhe koliformit, duke bërë të mundur klasifikimin e saj në grupin e shoqërive me performancë të kënaqëshme.

Operatori me performancën më të dobët vazhdon të jetë shoqëria SHA UK Durrës me parametra të klorit mbetës dhe koliformit në rënie, pa u përpjekur të përmirësojë situatën.

⁶ Shoqëritë që paraqesin përsëritje të pikave të ndotura janë: SHA UK Tiranë, SHA UK Peshkopi, SHA UK Malësi e Madhe, SHA UK Lezhë dhe SHA UK Has

Grupi dytë i shoqërive:

Në këtë grup nga 19 operatorë, 12 prej tyre ofrojnë për konsumatorët “ujë cilësisht të pijshëm” të cilët janë për t’u përgëzuar për punën e bërë si dhe për performancën e qëndrueshme.

SHA UK Mallakastër, SHA UK Rrogozhinë dhe SHA U Korçë Fshat kanë raportuar të dhëna vetëm për klorin mbetës.




Figura 24. Cilësia e ujit të pijshëm për grupin 2 në vitin 2012

Të dhënat mbi ujin e pijshëm për SHA U Kurbin tregojnë një rritje të ndjeshme për të dy parametrat por dhe një paqëndrueshmëri të këtij operatori për 3 vitet e fundit sidomos për normën e sigurisë për bakterin koliform. SHA U Tepelenë ka pësuar rënie në normën e sigurisë së klorit dhe në atë të koliformeve, SH.A.UK Kukës ka qëndrueshmëri përsa i përket klorit mbetës por bakteri koliform vazhdon të jetë në kufijtë e papranueshme megjithë përpjekjet e bëra ndërsa SHA U Lushnjë Fshat ka rënie në normën e sigurisë së klorit mbetës.

Ecuria në rënie dhe luhatjet e mëdha të këtyre rezultateve për disa shoqëri përbëjnë një shqetësim konkret për ERRU.

Grupi tretë i shoqërive:

Në këtë grup nga 28 operatorë, 18 prej tyre vazhdojnë të shërbejnë “ujë cilësisht të pijshëm” sipas standarteve shqiptare. Vlen të theksohet që kemi rritje të operatorëve me performancë të dobët krahasuar kjo me vitin 2011. Disa prej tyre nuk raportojnë të dhëna dhe pjesa tjetër raportojnë vetëm për bakterin koliform. Nga analiza e bërë në grafikun e grupit të tretë, vërehet se shoqëria SHA U Malësi e Madhe nuk ka raportuar të dhëna për këtë vit, kjo për shkak se ka qënë e pamundur kryerja e testeve nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik.




Figura 25. Cilësia e ujit të pijshëm për grupin 3 për vitin 2012

Në grafik vihet re që SHA U Çorovodë ka një rënie të ndjeshme përsa i përket bakterit koliform, SHA U Malësi e Madhe vazhdon të mos raportojë por nga të dhënat e marra nga ISHP vihet re që kjo shoqëri ka dështuar në arritjen e standarteve. SHA U Gjirokastrë Fshat nuk ka raportuar për këtë vit të dhënat e këtij treguesi ndërsa SHA UK Ersekë dhe SHA U Bulqizë nuk kanë raportuar të dhëna për koliformin. Një shqetësim të veçantë paraqet SHA UK Peqin e cila ka rënie të ndjeshme përsa i përket klorit mbetës duke zbritur nën standartet e lejuara.

Përfundime

Nga analizat e kryer për të 3 grupet e shoqërive UK, shumica e tyre u shërben konsumatorëve ujë cilësisht të pastër, sipas standarteve shqiptare. Problem më të madh paraqesin operatorët e grupit të dytë dhe të tretë. Të dhënat e marra nga vetë operatorët si dhe ato të ISHP tregojnë që konsumatorët jo gjithmonë janë të sigurt dhe mbrojtur gjatë përdorimit të ujit të rrjetit.

Nivelet e normës së sigurisë të vetëdeklaruar nuk pasqyrojnë situatën reale për këtë tregues, kjo vërtetohet më së miri nga përdorimi i ujit të blerë edhe nga konsumatorët e shoqërive të cilët kanë 100 % normën e sigurisë së klorit dhe bakterit koliform. Shumë nga shoqëritë nuk kryejnë klorimin e ujit në sasive të duhur dhe gjatë gjithë muajit.

ERRU kujdeset që shoqëritë e licensuara të kenë prioritet zbatimin e procedurave të përshtatshme në mënyrë që konsumatorët të mbahen të informuar lidhur me cilësinë e furnizimit me ujë dhe riskun e ndotjes. Është gjithashtu e nevojshme që procedurat mbi kampionimin dhe testimin e cilësisë së ujit të përfshihen të jenë në përputhje me praktikën më të mirë, d.m.th në intervale të rregullta në secilin prej impianteve të trajtimit, rezervuarëve si dhe një përzgjedhje rastësore nga rubinetet e konsumatorëve. Në këtë kuadër ERRU bashkëpunon me ISHP dhe me DSHP në Ministrinë e Shëndetësisë, nën varësinë e së cilës janë këto institucione, për të qënë gjithmonë koherent në lidhje me situatën si dhe vazhdimisht kërkon që të shtohen sa më shumë pika monitorimi si në zonat urbane dhe ato rurale.

Shihet qartë përpjekja e shumë operatorëve për të përmirësuar standartet e cilësisë së ujit në pikën e furnizimit. Disa nga faktorët që ndikojnë në cilësinë e ujit dhe ç'rregullime në furnizim janë: (i) furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, (ii) ndryshimet në presionin e ujit, (iii) shpimi i tubave për lidhje të paligjshme, (iv) mbajtja e ujit në depozita, dhe (v) pompat thithëse të instaluar nga konsumatorët për të kompensuar presionin e ulët të rrjetit.

Gjatë vitit 2012 ERRU intensifikoi bashkëpunimin e tij me ISHP dhe Ministrinë e Shëndetësisë pikërisht për të përmirësuar cilësinë e informacionit të shkëmbyer.

3.9 Mbulimi me Kanalizime

Në sektorin ujësjellës kanalizime vetëm 30 shoqëri i ofrojnë të dy shërbimet: (i) furnizimin me ujë dhe (ii) largimin e ujërave të ndotura. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë, ka pasur gjithmonë prioritet nga shoqëritë duke lënë pas dore sektorin e kanalizimeve.

Treguesi i mbulimit me shërbim kanalizimi llogaritet nga raporti i popullsisë të cilës i ofrohet shërbimi i largimit të ujërave të ndotura (por jo domosdoshmërisht trajtimi i tyre) dhe popullsisë së përgjithshme që jeton në zonën e juridiksionit. Lëvizja demografike ka sjellë si rezultat luhatjen e këtij treguesi për disa operatorë UK. Objektivi i performancës së mirë i vendosur nga ERRU është 75%. Mesatarja për të gjitha shoqëritë gjatë vitit 2012 është 51%, nivel ky pothuajse i njëjtë me një vit më parë.

Grupi parë i shoqërive:

Nga grafiku vihet re që shoqëria Elber shpk ka rritur ndjeshëm këtë tregues duke realizuar mbulimin me kanalizime për qytetin e Elbasanit në 100%. SHA UK Korçë vazhdon të ketë të njëjtin tregues për 3 vitet e fundit.




Figura 26. Mbulimi me kanalizime për grupin 1 në vitin 2012

Ky tregues për SHA UK Tiranë dhe Shkodër ka pësuar rënie si rezultat i rritjes së numrit të klientëve. Përkje për rritjen e këtij treguesi kanë bërë SHA UK Fier, Durrës dhe Berat Kuçovë. SHA UK Kavajë mbetet përsëri shoqëria me nivelin më të ulët për sa i përket mbulimit me kanalizime.

Grupi dytë i shoqërive:

Në grupin e dytë nga 19 shoqëri, 11 ofrojnë shërbime kanalizimi dhe vetëm SHA UK Pogradec ka impiant për trajtimin e ujërave të ndotura. Në kete grup kanë arritur të qëndrojnë mbi kufirin e verdhë të benchmarking për performancë të mirë SHA UK Krujë 93.8 %, SHA UK Lezhë 90.7 %, SHA UK Pogradec 75.40 % dhe SHA UK Librazhd 84.23 % ndërsa SHA UK Sarandë është shumë afër arritjes së benchmarking për performancë të mirë me tregues 74.98 %, SHA UK Kukës qëndron në të njëjtat parametra për 3 vitet e fundit.




Figura 27. Mbulimi me kanalizime për grupin 2 në vitin 2012

Nga grafiku vihet re se SHA UK Burrel ka një rënie prej 14.58 % krahasuar me vitin 2011 por përsëri mbetet në parametra të pranueshëm përse i përket kufirit të benchmarking për performancë të mirë. Rritja e numrit të popullsisë së zonës së juridiksionit për SHA UK Lushnjë ka bërë që kjo shoqëri të pësojë një ulje prej 12.27 % duke iu afruar kështu kufirit të vendosur nga benchmarking për performancë të dobët.

Niveli i mbulimit me kanalizime për SHA UK Rrogozhinë, Gjirokastrë dhe Mallakastër i rendit ato si shoqëritë me performancën më të dobët në këtë grup.

Grupi tretë i shoqërive:

Në grupin e 3 vetëm SHA UK Ersekë është shoqëria e vetme e cila ofron shërbimin me kanalizime në 100 % të zonës së mbulimit. është për t'u vlerësuar SHA UK Delvinë e cila ka zgjeruar zonën e saj të shërbimit në vlerën 51.83% duke bërë të mundur kalimin e kufirit minimal të vendosur. SHA UK Krastë dhe Mirditë vazhdojnë të kenë të njëjtin nivel përsa i përket % së mbulimit me kanalizime.




Figura 28. Mbulimi me kanalizime për grupin 3 në vitin 2012

Në këtë grup 6 prej shoqërive vazhdojnë të mbeten nën vijën e kuqe duke patur kështu një performancë të dobët, SHA UK Pukë Fshat ka treguesin me nivel më të ulët duke ofruar shërbim vetëm për 2.1 % të popullsisë.

ERRU e shihet me shqetësim gjendjen e këtyre shoqërive dhe mos angazhimin e tyre për të dalë nga kjo gjendje.

Përfundime

Analiza e mësipërme e të 3 grupeve tregon se shumë pak nga shoqëritë kanë bërë përpjekje për të ndryshuar gjendjen ndërkohë që shumica kanë mbetur pothuaj në të njëjtat nivele të ulëta sikurse një vit më parë. Për vitin 2012 vlen të theksohet që shoqëria UK Korçë ka rritur nivelin e shërbimit për këtë aktivitet duke vënë në shfrytëzim impjantin e trajtimit të ujërave të ndotura dhe duke e çuar në 4 numrin e Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Shqipëri. Rritja e numrit të impjanteve do të përmiresojë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e konsumatorëve.

Po kështu ka përfunduar puna për ndertimin e impianteve të reja të trajtimit të ujërave të ndotura edhe për zonat Lezhë-Shëngjin dhe Sarandë, ndërkohë po vazhdon puna për ndërtimin e disa impianteve të tjerë.

Trajtimi i ujërave të ndotura është një shërbim i kushtueshëm. Si rregullator i sektorit, ERRU është i vetëdijshëm për kostot shtesë që sjell rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit (që shumë nga shoqëritë janë duke bërë) veçanërisht kur bëhet fjalë për investime të siguruara nga shteti ose donatorët. Megjithatë është e arsyeshme që së paku një pjesë e kostove të mbulohen përmes tarifave, mbulimi total i kostove mund të shkaktojë shqetësim tek konsumatorët lidhur me përballimin e këtyre kostove. Si rrjedhojë, duhet që të gjenden mekanizma të përshtatshme subvencionimi për të bërë të mundur mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe njëkohësisht funksionimin e këtyre sistemeve në mënyrë të qëndrueshme.

ERRU si anëtare e grupit kombëtar të punës mbi kanalizimet dhe e grupit përkatës të zbatimit të strategjisë përgjegjës për hartimin e një mekanizmi të orientuar subvencionimi për shtresat në nevojë, do të ofrojë këshillat e saj dhe do të kontribuojë në zhvillimin dhe zbatimin në të ardhmen e strategjive dhe mekanizmave të përshtatshme.

3.10 Perceptimi Rregullator

Me qëllim që ERRU të krijoj një ambjent rregullator transparent dhe të qëndrueshëm si dhe të funksionojë efektivisht, nevojitet një bashkëpunim i mirë me shoqëritë. Ato duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në ligjet e rregulloret në fuqi, si dhe të jenë pjesëmarrës aktive në procesin rregullator. Për vlerësimin e marrëdhënieve ndërmjet ERRU dhe shoqërive ujësjellës kanalizime është përdorur treguesi “Perceptimi Rregullator”. Ky tregues merr në konsideratë katër aspekte kryesore. Rezultati i përgjithshëm është 100 pikë për çdo shoqëri që ka treguar përpjekje të vazhdueshme për arritjen e tij gjatë vitit 2012. Secili prej aspekteve të mëposhtme vlerësohen me 25 pikë maksimumi:

- **Liçensimi:** nëse shoqëria operon me liçensë të vlefshme nga ERRU;
- **Tarifë e miratuar nga ERRU:** nëse shoqëria operon me tarifë të miratuar nga ERRU;
- **Pagesat rregullatore:** nëse shoqëria ka kryer pagesat rregullatore kundrejt ERRU në kohë dhe në masë të plotë (maksimumi 25 pikë, me një pjesë të pikëve nëse pagesat nuk janë kryer plotësisht);
- **Komunikimi me ERRU:** nëse shoqëria u është përgjigjur informacioneve, kërkesave apo njoftimeve të ndryshme bërë nga ERRU (maksimumi 25 pikë kur të gjitha përgjigjet janë dhënë në kohë dhe të plota);

Tabela 6 liston pikët e dhëna 57 shoqërive për secilin nga këto aspekte, duke i renditur ato në grupet përkatëse sipas pikëve të përgjithshme të marra për këtë tregues.

Tabela 6. Perceptimi Rregullator: Pikët e performancës të arritura sipas grupeve

Shoqëritë			Liçensimi	Tarifë e miratuar nga ERRU	Pagesat rregullatore	Komunikimi me ERRU	PIKET TOTALE
Grupi 1	UK	Korçë	25	25	25	14	89
	UK	Elber sh.p.k	25	25	25	14	89
	UK	Tiranë	25	25	16	22	88
	UK	Shkodër	25	25	17	16	83
	UK	Berat-Kuçovë	25	25	7	20	77
	UK	Durrës	25	25	4	19	73
	UK	Fier	25	25	12	6	68
	U	Vlorë	25	25	3	10	63
	U	Elbasan Fshat	25	25	-	8	58
Grupi 2	UK	Kavajë	25	25	-	8	58
	UK	Lezhë	25	25	25	20	95
	UK	Gjirokastrë	25	25	25	17	92
	U	Përmet	25	25	25	14	89
	UK	Librazhd	25	25	20	17	87
	UK	Pogradec	25	25	11	25	86
	UK	Lushnjë	25	25	9	20	79

Shoqëria			Licencimi	Tarifë e miratuar nga ERRU	Pagesat rregullatore	Komunikimi me ERRU	PIKËT TOTALE
Grupi 2	UK	Sarandë	25	25	10	14	74
	UK	Rrogozhinë	25	25	-	14	64
	U	Peshkopi	25	25	-	12	62
	U	Tepelenë	25	25	-	11	61
	UK	Kukës	25	25	-	10	60
	UK	Krujë	25	25	-	10	60
	UK	Burrel	25	25	-	8	58
	U	Gramsh	25	25	-	8	58
	U	Kurbini	25	25	-	6	56
	U	Lushnjë Fshat	25	25	-	4	54
	U	Patos	25	-	-	6	31
	U	Korçë Fshat	25	-	-	4	29
	UK	Mallakastër	-	-	-	10	10
Grupi 3	U	Orikum	25	25	25	3	78
	U	Bilisht	25	25	17	8	75
	U	Delvinë	25	25	15	8	73
	UK	Ersekë	25	25	-	17	67
	UK	Pukë	25	25	-	14	64
	U	Polican	25	25	-	11	61
	U	Selenicë	25	25	-	11	61
	UK	Rubik	25	25	-	10	60
	U	Gjirokastrë Fshat	25	25	-	8	58
	UK	Krastë	25	25	-	8	58
	U	Ura Vajgurore	25	25	-	8	58
	U	Shkodër Fshat	25	25	-	8	58
	U	Tropojë	25	25	-	8	58
	U	Çorovodë	25	25	-	6	56
	UK	Mirditë	25	25	-	6	56
	U	Novoselë	25	25	-	3	53
	UK	Peqin	25	25	-	3	53
	U	Bulqizë	25	-	-	14	39
	U	Malësi e Madhe	25	-	-	11	36
	U	Vau i Dejës	25	-	-	11	36
	U	Has	25	-	-	8	33
	UK	Fushë Krujë	-	25	-	8	33
	UK	Himarë	25	-	-	3	28
	U	Divjakë	-	-	-	10	10
	U	Këlcyrë	-	-	-	8	8
	UK	Libohovë	-	-	-	8	8
	UK	Fushë Arrëz	-	-	-	6	6
	UK	Pukë Fshat	-	-	-	6	6

Licencimi

Liçensa është instrumenti kryesor që një shoqëri të mund të kryej aktivitetin e saj në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime. Për këtë arsye, ERRU bën përpjekje të vazhdueshme për nxitjen e njësive të qeverisjes vendore që ato të ofrojnë shërbime përmes shoqërive të liçensuara. Gjatë vitit 2012 numri i shoqërive të liçensuara është 50 nga 29 që ishte disa vite më parë.

Gjatë vitit 2012 kane aplikuar 28 shoqëri nga të cilat 17 janë pajisur tashmë me liçensë dhe 11 të tjera janë duke u shqyrtuar. Për herë të parë gjatë këtij viti kanë aplikuar dhe janë liçensuar SHA UK Himarë dhe SHA U Vau i Dejës. Dy shoqëri kanë aplikuar për rinovim liçense për efekt të ndryshimeve të drejtuesve ligjore apo teknike ndërsa 14 shoqëri të tjera për efekt të mbarimit të afatit. Puna do të vazhdojë duke qenë se SHA UK Mallakastër, SHA U Divjakë, SHA UK Fushë Krujë, SHA U Këlcyrë, SHA U Libohovë, SHA UK Fushë Arrëz dhe SHA UK Pukë Fshat të cilat akoma operojnë pa liçensë. ERRU është në dijeni se ka arsye objektive që nuk lejojnë disa nga shoqëritë që të përmbushin kërkesat ligjore të liçensimit, siç edhe përmenden në pjesën 1, dhe për këtë arsye janë duke u bërë përpjekje për të gjetur zgjidhjet e duhura.

Tarifat e Miratuara nga ERRU

Pjesa më e madhe e shoqërive ujësjellës kanalizime (44 nga 57) operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU. Gjatë vitit 2012, aplikuan për miratim tarifash të reja 10 shoqëri, SHA U Bulqizë aplikoi për herë të parë dhe tarifat hyjnë në fuqi në Janar të vitit 2013. Gjithsesi, janë edhe 12 shoqëri të tjera që operojnë me tarifa të pamiratuara nga ERRU: SHA U Korçë Fshat, SHA U Patos, SHA UK Mallakastër, SHA UK Himarë, SHA U Has, SHA U Vau i Dejës, SHA U Malësia e Madhe, SHA UK Libohovë, SHA U Divjakë, SHA UK Fushë Arrëz, SHA U Këlcyrë, dhe SHA UK Pukë Fshat. ERRU ka bërë përpjekje të vazhdueshme me të gjitha shoqëritë me qëllimin formimin dhe nxitjen e tyre për të operuar sipas rregullave të vendosura, por në pamundësi, parashikon të ushtrojë kompetencat që i jep ligji.

Pagesat Rregullatore

Me miratimin e tarifave nga ERRU, shoqërive ujësjellës kanalizime u lind detyrimi që të kryejnë çdo vit një pagesë rregullatore, sipas ligjit. Gjatë vitit 2012, shumë shoqëri nuk e kanë paguar rregullisht detyrimin e tyre ndaj ERRU. Vetëm 6 shoqëri e kanë paguar plotësisht këtë detyrim: SHA UK Elber, SHA UK Korçë, SHA UK Gjirokastrë, SHA UK Lezhë, SHA U Permet, dhe SHA U Orikum. 12 shoqëri të tjera kanë bërë pagesa të pjesëshme duke mos e përmbushur plotësisht detyrimin e tyre financiarë ndaj rregullatorit. Këtu përfshihen edhe shoqëri për të cilat pjesa e pa shlyer është e ulët por detyrimi i pa paguar është i konsiderueshëm, duke iu referuar madhësisë së shoqërisë. Nga ana tjetër është rritur numri i shoqërive të tjera të cilat nuk kanë shlyer asnjë detyrim për këtë vit. Disa nga këto shoqëri nuk i kanë kryer pagesat e tyre ndaj ERRU për vite me radhë, siç janë: SHA UK Berat - Kuçovë, SHA UK Durrës, SHA UK Fier, SHA U Vlorë, SHA UK Kavajë, SHA U Gramsh, SHA UK Sarandë, SHA UK Burrel, SHA UK Krujë, SHA U Tepelenë, dhe SHA U Lushnjë Fshat.

Komunikimi me ERRU

Në zbatim të ligjit, shoqëritë janë të detyruara të ofrojnë informacionin e nevojshëm për funksionimin eficient të ERRU. ERRU vetë është i interesuar për krijimin e një marrëdhënie sa më të mirë me shoqëritë duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me to për çështje të ndryshme, si p.sh paraqitje të dhënash, konsultime dhe njoftime për kryerjen e pagesave. Komunikimi me ERRU u vlerësua bazuar mbi bashkëpunimin e shoqërive lidhur me 9 nga kërkesat për informacion dhe pjesëmarrje në aktivitet e organizuara nga ERRU. Vlen për t'u theksuar bashkëpunimi shumë i mirë me SHA UK Pogradec në implementimin e metodologjisë së vendosjes së tarifave ku kjo shoqëri u trajtua si

rast pilot. Siç tregojnë dhe pikët e rezultatit, asnjë prej shoqërive nuk ka shprehur bashkëpunim maksimal. Ndërsa shoqëritë si: SHA U Korçë Fshat, SHA U Lushnjë Fshat, SHA UK Himarë, SHA U Novoselë kanë treguar interesin më të dobët ndaj kërkesave të rregullatorit.

Komunikimi me ERRU do ta vazhdojë të jetë një aspekt i rëndësishëm, bazë për vlerësimin e marrëdhënies mes shoqërive dhe ERRU.

Përfundime

Sektori ujësjellës kanalizime gjithmonë e më shumë është duke ushtruar aktivitetin e tij bazuar në kuadrin rregullator. ERRU nëpërmjet politikës së tij të bashkëpunimit dhe konsultimit në zhvillimin e mëtejshëm të instrumentave rregullatore ka bërë të mundur që shoqëritë të ndërgjegjësohen dhe të vlerësojnë rolin e tij në rregullimin e sektorit. Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e shoqërive janë pjesëmarrës aktive në këtë proces. Por ka ende shoqëri, kryesisht të vogla, që për arsye të mos plotësimit të kërkesave formale nuk kanë vlerësim të mirë të treguesit të perceptimit rregullator. Këto shoqëri mund të përmirësojnë performacën e këtij treguesi duke rritur komunikimin dhe bashkëpunimin me ERRU.

ERRU vlerëson korrektësinë dhe përpjekjet e të gjitha shoqërive për të patur patur një bashkëpunim sa më të mirë, në veçanti SHA UK Lezhë dhe SHA UK Gjirokastrë të cilët vlerësohen si shembujt të mirë në këtë drejtim, shembuj që duhet të ndiqen edhe nga shoqëritë e tjera.



4

Renditja e shoqërive ujësjellës kanalizime sipas performancës për vitin 2012



Në këtë pjesë është pasqyruar vlerësimi i ecurisë së shoqërive ujësjellës kanalizime sipas performancës së tyre të përgjithshme. Shoqëritë janë renditur bazuar në totalin e pikëve të grumbulluara nga vlerësimi i TKP-ve.

ERRU nëpërmjet kësaj metode vlerësimi ka bërë të mundur identifikimin e shoqërive me performancën më të mirë dhe më të dobët. Nga ana tjetër nëpërmjet renditjes dhe publikimit të përvitshëm të rezultateve synon nxitjen e operatorëve për përmirësimin e performancës. Publikimi i këtyre treguesve nëpërmjet këtij raporti vjetor rrit informimin për një publik më të gjerë lidhur me zhvillimet në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

ERRU është përpjekur që vlerësimi i performancës së shoqërive të jetë sa më real dhe për këtë një rol të rëndësishëm luan cilësia e të dhënave të raportuara. ERRU është duke punuar dhe do të vazhdojë të punojë për rritjen e besueshmërisë së të dhënave duke qartësuar dhe korrigjuar mospërputhjet e gjetura. Puna e filluar në vitin 2012 me DPUK duke zbatuar kalendar vizitash të përbashkëta me programe të përcaktuara qartë, sidomos në shoqëritë ku janë hasur të dhëna me probleme do të vazhdojë. Për periudhën në vazhdim, në programin e punës të ERRU një vend të rëndësishëm do të zënë programet e kontrollit të të dhënave të raportuara nga operatorët, në veçanti për të dhënat që lidhen me TKP, zbatimin e kuadrit ligjor dhe shërbimin ndaj konsumatorit.

Renditja e shoqërive sipas performancës së përgjithshme

Shoqëritë janë renditur sipas pikëve totale të performancës të llogaritura mbi bazën e vlerësimit të 9 nga 10 TKP, ku secili prej tyre ka një peshë specifike të caktuar që tregon rëndësinë relative të treguesve.

Sistemi i pikësimit paraqitet në tabelën 7 më poshtë. Maksimumi i pikëve që mund të arrihen është 100 pikë. Çdo TKP vlerësohet me një rezultat maksimal nga 5 deri në 20 pikë, në varësi të peshës specifike që i është caktuar dhe ka kufijtë e tij maksimalë dhe minimalë të performancës. Performanca e mirë në nivelin e benchmarking ose mbi vlerësohet me maksimumin e pikëve. Përgjithësisht, nëse performanca është nën këtë objektiv, me qëllim inkurajimin dhe vlerësimin hap pas hapi të përmirësimeve vlerësimi bëhet për vetëm një përqindje të pikëve në dispozicion. Për disa tregues si – efienca e stafit, uji pa të ardhura, norma e arkëtimit dhe cilësia e ujit të pijshëm – performanca në nivelin apo nën nivelin minimal të pranueshëm të benchmarking vlerësohet me zero pikë. Rezultati i përgjithshëm arrihet fare thjeshtë duke mbledhur të nëntë rezultat e arritura për të gjitha TKP.

Tabela 7. Sistemi i renditjes së shoqërive: Treguesit Kryesorë të Performancës, benchmarking, pesha e specifikë për çdo TKP, pikët

Treguesit Kryesorë të Performancës		Benchmarking i performancës		Pesha specifike	Pikët maksimale
		Pikë të plota	0 pikë	Totali 100%	
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	0%	15%	15
2 – Mbulimi Total i Kostove		TKP nuk është përfshirë në vendosjen e pikëve			
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 80%	≤ 60%	20%	20
4 – Eficienca e Stafit (staf/1000 lidhje)	Grupi 1	≤ 4	≥ 6	5%	5
	Grupi 2	≤ 6	≥ 10		
	Grupi 3	≤ 10	≥ 15		
5 – Uji pa të Ardhura		≤ 30%	≥ 50%	15%	15
6 – Niveli i Matjes		≥ 85%	0%	15%	15
7 – Orët e Furnizimit		≥ 18 orë/ditë	0	10%	10
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm		≥ 98%	≤ 90%	10%	10
9 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	0%	5%	5
10 – Perceptimi i Rregullator		25 pikë	0 pikë	5%	5

Rezultatet e renditjes për vitin 2012

Për të 57 shoqëritë janë llogaritur rezultatet e përgjithshme të performancës në bazë të pikëve dhe pozicionimi në renditje i secilës shoqëri. Këto rezultate janë pasqyruar në Tabelën e “renditjes së shoqërive” për vitin 2012 (tabela 8).

Tabela 8. Tabela e renditjes së shoqërive

Renditja	Lloji i aktivitetit	Shoqëria	Pikët e renditjes	Renditja	Lloji i aktivitetit	Shoqëria	Pikët e renditjes
1	UK	Pogradec	99.08	29	UK	Durrës	55.79
2	UK	Korçë	98.94	30	U	Tepelenë	53.76
3	UK	Librazhd	98.42	31	U	Ura Vajgurore	52.01
4	UK	Tiranë	78.08	32	UK	Libohovë	50.83
5	UK	Lezhë	78.06	33	U	Lushnjë Fshat	50.58
6	U	Delvinë	76.67	34	UK	Krastë	49.96
7	U	Përmet	74.16	35	UK	Mallakastër	49.11
8	U	Gramsh	72.49	36	UK	Selenicë	48.18
9	UK	Elber sh.p k	71.84	37	UK	Shkodër	47.89
10	U	Divjakë	71.21	38	U	Peshkopi	47.68
11	U	Elbasan Fshat	70.42	39	U	Kelcyre	46.36
12	UK	Rrogozhinë	68.59	40	UK	Fushë Krujë	46.07
13	UK	Burrel	67.39	41	U	Vlorë	45.31
14	UK	Rubik	67.16	42	U	Polican	44.82
15	UK	Fier	66.91	43	UK	Mirditë	43.16
16	UK	Lushnjë	66.84	44	U	Shkodër Fshat	43.06
17	UK	Ersekë	66.29	45	U	Bulqizë	42.45
18	U	Bilisht	66.08	46	U	Patos	41.55
19	UK	Kavajë	66.07	47	UK	Pukë Fshat	40.08
20	UK	Pukë	66.04	48	U	Novoselë	37.41
21	UK	Berat - Kuçovë	63.42	49	UK	Fushë Arrëz	33.84
22	UK	Sarandë	61.69	50	U	Orikum	31.28
23	UK	Krujë	60.89	51	U	Tropojë	29.47
24	UK	Kukës	60.48	52	UK	Peqin	27.90
25	UK	Himarë	60.25	53	U	Vau i Dejës	25.90
26	U	Gjirokastër Fshat	59.58	54	U	Has	22.14
27	U	Korçë Fshat	58.48	55	U	Kurbin	21.24
28	UK	Gjirokastër	56.15	56	U	Malësi e Madhe	19.18
				57	U	Çorovodë	16.94

Performuesit më të mirë

Performuesit më të mirë në secilin grup për vitin 2012 paraqiten në tabelën 9, arritjet e të cilëve do të vlerësohen me një çmim nga ERRU. Pavarësisht nga rezultati, çmimi mund të merret vetëm nga shoqëritë të cilat operojnë në perputhje me kuadrin rregullator, pra kanë një licensë të vlefshme dhe tarifa të miratuara nga ERRU.

Tabela 9. Performuesit më të mirë në Renditjen e Shoqërive për Vitin 2012

Renditja	Grupi 1		Grupi 2		Grupi 3	
	Shoqëria	Pikët e renditjes	Shoqëria	Pikët e renditjes	Shoqëria	Pikët e renditjes
1	Korçë	98.94	Pogradec	99.08	Delvinë	76.67
2	Tiranë	78.08	Librazhd	98.42	Divjakë	71.21
3	Elber sh.p.k	71.84	Lezhë	78.06	Rubik	67.16

SHA UK Korçë vazhdon të jetë shoqëria me performancën më të mirë në grupin e parë, me një diferencë të konsiderueshme pikësh nga shoqëritë e vendit të dytë dhe të tretë, përkatësisht SHA UK Tiranë dhe Elber sh.p.k. Në grupin 2, SHA UK Pogradec renditet i pari, i ndjekur me një diferencë të vogël nga SHA UK Librazhd në vendin e dytë dhe SHA UK Lezhë në të tretin. Në grupin 3, udhëheq SHA U Delvinë e ndjekur, nga SHA U Divjakë në vendin e dytë dhe SHA UK Rubik në të tretin.

Shoqëritë me ecurinë më të mirë në kohë

Renditja e shoqërive në bazë të pikëve të grumbulluara pasqyron arritjet aktuale të tyre dhe shërben për identifikimin e shoqërive me nivelin më të mirë të performancës sipas grupeve përkatëse. Por ka edhe shoqëri, edhe pse jo të renditura në vendet e para, që kanë bërë përpjekje domethënëse për të përmirësuar shërbimet dhe menaxhimin e tyre. Ecuria e mirë e punës së tyre ka sjellë më shumë pikë të grumbulluara krahasuar me një vit më parë.

ERRU nëpërmjet treguesit “shoqëritë me ecurinë më të mirë” ka vlerësuar shoqëritë që bëjnë progres në performancën e tyre, duke marrë parasysh edhe faktin se sistemi i renditjes nuk mund të kompensojë pabarazinë mes shoqërive, e cila vjen edhe për shkak të faktorëve të jashtëm si dhe të organizimit apo gjendjes së sistemit të tyre ujësjellës kanalizime. Tabela 10 më poshtë paraqet “shoqëritë me ecurinë më të mirë” në secilin nga tre grupet.

Tabela 10. Shoqëritë me Ecurinë më të Mirë në Renditje për Vitin 2012

Shoqëria		Renditja në grup	Pikët e renditjes 2011	Pikët e renditjes 2012	Ndryshimi në pikët e renditjes
Grupi 1	Vlorë	10	34.55	45.31	+ 10.76
Grupi 2	Lezhë	3	68.10	78.06	+ 9.95
Grupi 3	Ura Vajguore	9	34.20	52.01	+ 17.81

SHA UK Vlorë e renditur në vendin e 10-të për grupin e parë, shënon 10.76 pikë më shumë në performancën e vitit 2012 sesa viti 2011. Në grupin 2, SHA UK Lezhë përveçse e renditur në vendin e tretë është edhe shoqëria me ecurinë më të mirë me 9.95 pikë më shumë sesa një vit më parë. Ura Vajguore ka mundur ta rrisë performancën e vitit 2012 me 17.81 pikë më shumë krahasuar me një vit më parë.

Përgëzime dhe perspektiva

ERRU ka vlerësuar me pikë maksimale të gjitha shoqëritë me performancën dhe ecurinë më të mirë për vitin 2012, dhe i përgëzon ato për punën e bërë për të ofruar një shërbim sa më të mirë për konsumatorët në zonën e tyre të shërbimit.

Për këto shoqëri është e rëndësishme të vazhdojnë të punojnë për t'i ruajtur dhe çuar më përpara rezultatet e arritura. Shoqëritë e tjera duhet të pranojnë përballjen me sfidën e përmiresimit të shërbimit për konsumatorët. Eksperiencat e më të mirëve tregojnë se një menaxhim i mirë sjell për konsumatorët edhe një shërbim më të mirë.



5

Tema e veçantë për vitin 2012: Këndvështrimi i ERRU për shërbim me cilësi më të mirë



ERRU e ka vendosur mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në fokus të punës së tij, duke synuar eficiencën dhe përmirësimin e shërbimeve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë tek konsumatorët.

Vlerësimi i konsumatorëve në lidhje me shërbimin e ofruar nga shoqëria, në mënyrë të veçantë është i lidhur ngushtë me dy aspekte: çmimin dhe cilësinë. Në ndryshim nga shumë shërbime të tjera, në rastin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime konsumatorët kanë pak ose asnjë alternative tjetër për të zgjedhur, nëse janë të pakënaqur nga shërbimi i ofruar. Megjithatë ata mund të furnizohen në mënyrë të vazhdueshme me ujë dhe me një çmim të kënaqshëm, disa tregues mbi cilësinë e ujit, siç është siguria mikrobiologjike, janë thuajse të pamundur të vlerësohen nga konsumatori i zakonshëm. Prandaj është detyrë e rregullatorit të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, përballueshmërinë, efikasitetin dhe besueshmërinë e shërbimeve.

Gjatë dy viteve të fundit, ERRU ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmbushur këtë detyrë si një nga detyrat kryesore ligjore të tij. Studimet e iniciuara nga ERRU gjatë kësaj periudhe në lidhje me shërbimin e kujdesit ndaj klientit në shoqëritë ujësjellëse kanalizime dhe perceptimin e konsumatorëve për këto shërbime kanë ndihmuar për të krijuar ide më të qarta në lidhje me marrëdhëniet konsumator-operatorë si dhe për të përcaktuar hapat e mëtejshme për rregullimin e tyre. Në mënyrë më të detajuar për këto studime është folur në raportin e performancës për vitin 2011.

Studimi "Shërbimi i kujdesit ndaj klientit" identifikoi shumë mangësi në lidhje me orientimin e shoqërive ndaj çështjeve të klienteve. Bazuar në këto gjetje, ERRU për të përmirësuar shërbimin ndaj klientit dhe për të vendosur marrëdhënie më të mira me publikun është duke hartuar udhëzuesin për shërbimin e kujdesit ndaj klientit.

Rezultatet e studimit "Mbi perceptimin e konsumatorëve për shërbimet ujësjellëse kanalizime", treguan se procesi rregullator merr në konsideratë çështjet më problematike që lidhen me konsumatorët. Monitorimi i performancës dhe vendosja e objektivave nga ERRU për operatorët është në përputhje me prioritetet e klientëve.

Një aspekt tjetër në përmirësimin e marrëdhënieve operator konsumator është zbatimi i kontratës model, si një kontratë e detyrueshme që përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet ndërmjet palëve. Të gjithë klientët deri në fund të vitit 2013 do të jenë pajisur me këtë kontratë. ERRU është duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme realizimin e planit të veprimit të hartuar për çdo shoqëri për këtë qëllim.

Vlerësimi i performancës së shoqërive UK për vitin 2012 konfirmon se ofruesit e shërbimit kanë ende punë për të arritur cilësi të pranueshme e aq më shumë për të arritur cilësi të mirë të shërbimit të ofruar. ERRU në këtë pjesë të raportit “temë e veçantë” ka zgjedhur aspektet e cilësisë së performancës së shërbimit dhe të rregullimit të tij, me synimin për të stimuluar një diskutim mbi çfarë mund dhe duhet të bëhet më tepër nga të gjithë aktorët për të arritur qëllimin: një shërbim me cilësi të lartë dhe të përballueshem për të gjithë konsumatorët.

Rregullimi i cilësisë së shërbimit në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në Shqipëri

Nëpërmjet rishikimit të metodologjisë të tarifave në vitin 2011, ERRU prezantoi një lidhje të drejtpërdrejtë midis performancës së shërbimeve dhe rregullimit të tarifave. Arritjet e objektivave të shoqërisë tani janë pjesë e miratimit të tarifave, objektiva këto që monitorohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndër treguesit kyç të performancës që përdoren për të vlerësuar performancën e shoqërisë, dy prej tyre lidhen direkt me cilësinë e shërbimit nga këndvështrimi i konsumatorëve: cilësia e ujit të pijshëm dhe orët e furnizimit. Të dy treguesit kanë të bëjnë me performancën teknike, domethënë “shërbimi përfundimtar” i ofruar dhe mënyra me të cilën është arritur. Orët e furnizimit dhe cilësia e ujit të pijshëm janë përzgjedhur nga një gamë e gjerë alternativash pasi përmirësimi i këtyre treguesve mbetet ende prioritet.

Performanca e shërbimit ndaj klientit, dmth cilësia e ndërveprimeve midis shërbimeve dhe klientëve të tyre, është një tjetër aspekt i cilësisë së shërbimit. Aktualisht, shoqëritë nuk vlerësohen me një tregues të tillë, kështu që ERRU inkurajon marrëdhënie më të mira ndërmjet konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimit përmes seancave dëgjimore të detyrueshme si pjesë e procesit të miratimit të tarifave dhe dispozitave në kontratën model të shërbimit hartuar nga ERRU.

Edhe pse ERRU është përgjegjës për rregullimin e tarifave dhe cilësinë e shërbimit, ka disa aspekte të rregullimit të cilësisë të shërbimit që janë të përbashkëta me institucione të tjera. Ndërsa cilësia e ujit të pijshëm është një tregues kyç i performancës që ndikon dukshëm në analizën e performancës të ERRU dhe renditjen e shoqërive, standardet e cilësisë së ujit të pijshëm aktualisht vendosen nga Instituti i Shëndetit Publik. Në këtë mënyrë përgjegjësia për monitorimin është ndarë ndërmjet autoriteteve të ndryshme, psh inspektimi dhe zbatimi i cilësisë së ujit të pijshëm është nën përgjegjësinë e Drejtorive Rajonale të Shëndetit Publik në varësi të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik pranë Ministrisë së Shëndetësisë. Siç është përmendur edhe në Raportin e Performancës 2011, pasaktesitë mbi të dhënat e cilësisë së ujit të pijshëm janë vënë në dukje edhe në vlerësimin e performancës dhe ERRU i ka ofruar Institutit të Shëndetit Publik një rishikim të përbashkët të situatës dhe nxitjen për marrjen e masave përmirësuese.

Gjithashtu, Këshillat Mbikqyrës janë përgjegjës për rregullimin e cilësisë së shërbimit, të cilët duhet të kenë një marrëveshje me shoqërinë për menaxhimin dhe performancën e shërbimeve. Në bazë të informacioneve që ka ERRU, ekzistojnë shumë pak marrëveshjeve të tilla të vlefshme. Nga këndvështrimi i ERRU ndikimi i qeverisjes lokale si pronarë dhe i këshillave mbikqyrës në drejtim të përmirësimeve të shërbimeve, deri më tani ka qenë shumë i kufizuar. ERRU inkurajon fuqimisht të gjitha këshillat mbikqyrës të marrin përgjegjësitë e tyre për monitorimin dhe ta bëjnë atë pjesë të kësaj marrëveshje. Për të bërë këtë ata duhet të përdorimin ekspertizën e ERRU në vendosjen e objektivave mbi performancën e shërbimeve të tyre.

Cilësia e furnizimi me ujë dhe kanalizime dhe burimet e financimit.

Në analizen e këtij viti, ERRU thekson së cilësia e shërbimit lë për të dëshiruar për shumë shoqëri, të cilat kanë vështirësi në aktivitetin e tyre të përditshëm dhe e kanë të pamundur bërjen e investimeve të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Gjetja e burimeve të financimit bëhet kështu një çështje vendimtare. Edhe pse është e qartë që rritja e tarifave është e nevojshme, në mënyrë graduale, nevojitet një koordinim i rregullimit të tarifave me burimet e tjera të financimit siç janë grantet, kreditë apo subvencionet. Në mënyrë të veçantë në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve me të ardhura të pakta, ky mbetet një shqetësim për ERRU.

Duke synuar arritjen e vetë financimit në sektor, domosdoshmërisht konsumatorët do të duhet të pranojnë një kosto më të lartë kundrejt cilësisë më të mirë të shërbimeve. Kjo nxjerr në pah çështjen e përballueshmërisë dhe faktin që konsumatorë të ndryshëm e vlerësojnë në mënyra të ndryshme cilësinë e shërbimit.

ERRU nëpërmjet publikimit të informacionit në faqen zyrtare të internetit synon gjithëpërfshirjen në proceset e rregullimit, në vecanti përfshirjen e konsumatorëve, në mënyrë që ato të jenë sa më transparente dhe të drejta.



6

Konkluzione dhe perspektiva për të ardhmen

Rezultatet e vlerësimit të performancës së gjendjes aktuale të sektorit dhe tendencës së tij, lejojnë të kemi një pasqyrë të qartë të evidentimit të problemeve që lidhen me zhvillimin e sektorit si dhe me përcaktimin e drejtimeve kryesore të punës për zgjidhjen e tyre.

Në këndvështrimin e rregullatorit, sektori është duke performuar gjithmonë e më shumë brenda kuadrit rregullator duke tentuar realizimin e objektivave të miratuara në strategjinë kombëtare të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2011-2017.

Me gjithë përpjekjet e bëra për të arritur në standartet e duhura të cilësisë së shërbimit për konsumatorët në shumë aspekte do të duhet ende shumë punë për të bërë.

Gjithashtu për ERRU rezultatet e këtij raporti do ta ndihmojnë për të përcaktuar drejtimet kryesore të rregullimit për të bërë të mundur përmbushjen e misionit dhe vizionit të tij për të patur një sektor ujësjelles kanalizime të qëndrueshëm financiarisht i cili ofron për të gjithë konsumatorët shërbime të një cilësie të lartë me çmime të arsyeshme.

Përmirësime të vazhdueshme janë të nevojshme të bëhen në disa drejtime kryesore.

Rritja e pavarësisë financiare dhe menaxhimi i përgjithshëm

Megjithëse janë bërë shumë përpjekje nga shoqëritë për të rritur pavarësinë financiare, një numër i konsiderueshëm prej tyre nuk janë në gjendje të përmirësojnë këtë tregues pa ndihmën e subvencioneve operacionale dhe investimeve të financuara nga buxheti i shtetit apo donatorët. Duke mos e konsideruar rritjen e tarifave dhe investimet si i vetmi faktor për përmirësimin e shërbimit, përmirësimi i treguesve financiarë dhe të menaxhimit merr një rëndësi të veçantë. Rritja e qëndrueshmërisë financiare është e lidhur edhe me përmirësime që varen nga puna e vetë shoqërisë. Elemenimi i kostove joefektive dhe ofrimi i shërbimeve me kosto të arsyeshme si dhe rritja e të ardhurave janë drejtimet kryesore ku menaxhimi luan një rol të rëndësishëm.

Një operim eficient kërkon: (i) menaxhim eficientë të stafit, përzgjedhje të stafit të kualifikuar dhe trajnimi i vazhdueshëm i tyre, organizim më i mirë i punës me qëllim reduktimin e stafit të tepërt e të panevojshëm, (ii) hartimin e planeve dhe programeve që lidhen me eficiencën e energjisë dhe menaxhimin e aseteve. Këto drejtime janë të lidhura me shpenzimet që zënë peshën specifike më të madhe në totalin e kostos.

Menaxhimi më i mirë sistemeve të faturimit dhe arkëtimit është gjithashtu një drejtim tjetër për të përmirësuar treguesit finaciare. Faturimi i të gjithë klientëve në zonën e shërbimit dhe në veçanti arkëtimi i të ardhurave, ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë. Planet e biznesit janë një instrument tjetër i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të shoqërive. ERRU mbështet të gjitha ato raste që kanë hartuar planet e tyre të biznesit si dhe ato që janë duke punuar për këtë qëllim. Gjithashtu rregullatori do të nxisë të gjitha shoqëritë e tjera të punojnë për të patur planet e tyre të biznesit. ERRU është duke punuar për hartimin e një udhëzuesi për këtë qëllim.

Reduktimi i ujit pa të ardhura

Problemi më serioz në sektor është niveli i lartë i ujit pa të ardhura i cili është i lidhur drejtpërsëdrejti me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive ujësjellës kanalizime. Niveli i lartë i humbjeve jep ndikim negativ në situatën financiare të shoqërisë pasi rrit kostot duke qënë se prodhohet më shumë ujë se sa nevojat. Gjithashtu nuk identifikohen burime potenciale të ardhurash nga përdoruesit e paligjshëm që nuk u faturohet ujë. Për shumë shoqëri nivelet e larta të këtij treguesi janë të lidhura jo vetëm me gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë por edhe me menaxhimin jo të mirë të tyre. Keshtu evidentimi, ndërprerja apo legalizimi do të përbënte një hap të parë për përmirësimin e situatës. Opronatorët duhet të kenë plane të qarta veprimi përsa i përkëtë angazhimeve konkrete për reduktimin e humbjeve të ujit.

Vendosja e matësave si në pikat e prodhimit dhe për klientët individual bën të mundur hartimin e bilanceve të ujit, evidentimin e humbjeve sipas llojit, hartimin e planveprimeve konkrete për reduktimin e tyre. Kjo do t'i ndihmonte shoqëritë në gjetjen e zgjidhjeve më të mira të mundshme dhe sa më pak të kushtueshme.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme është duke monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësave. Rezultatet e deritanishme tregojnë se ende nuk ka përfunduar vendosja e matësve për konsumatorët jofamiljar. Sipas akteve ligjore në fuqi ky proces duhet të kishte përfunduar në vitin 2010. ERRU do të vazhdojë të kërkojë nga shoqëritë vendosjen e matësve për këtë kategori konsumatorësh si dhe për të gjitha lidhjet e reja me qëllim reduktimin e nivele të larta të shërbimit të pamatur.

Garantimi i cilësisë së ujit të pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe të pastër është një nga prioritetet e punës së ERRU. Pjesa më e madhe e operatorëve furnizojnë me ujë të pijshëm cilësisht të pastër sipas standarteve shqiptare. Të dhënat e marra nga ISHP dhe vetë operatorët tregojnë se konsumatorët jo gjithmonë janë të sigurt dhe të mbrojtur gjatë përdorimit të ujit të rrjetit. Shumë shoqëri nuk kryejnë klorinimin e ujit sipas standartit. Ky fakt si dhe mungesa e një informacioni të besueshëm dhe në kohe bën që konsumatorët ta blejnë ujin e pijshëm edhe në ato zona ku uji është higjenikisht i pastër. Megjithatë drejtoritë e shëndetit publik dhe instituti i shëndetit publik janë përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm, ERRU kërkon që konsumatorët të sigurohen që furnizohen me ujë cilësisht të pastër. Vlerësimi i performancës në lidhje me këtë tregues është i lidhur me cilësinë e të dhënave dhe mënyrën e raportimit. ERRU është duke kërkuar përmirësimin e situatës në këtë drejtim bazuar në praktikën më të mira.

Vazhdimësia e shërbimit, ndryshimet në presionin e ujit, eliminimi i lidhjeve të paligjshme, mbajtja e ujit në depozita, instalimi i pompave thithëse të vendosur nga konsumatorët janë disa nga faktorët që ndikojnë në cilësinë e ujit të pijshëm.

ERRU gjithashtu e sheh cilësinë e ujit të lidhur me një sërë masash që shoqëritë vetë duhet të ndërmarrin për një administrim më të mirë të sistemeve të furnizimit me ujë.

Përmirësimi i shërbimit me kanalizime dhe mbrojtja e mjedisit

ERRU në mënyrë të vazhdueshme është duke theksuar rëndësinë e përmirësimit të shërbimeve të kanalizimeve shërbim i cili aktualisht nuk është ende në standartet e kërkuara. Megjithatë vlen të theksojmë se po bëhen hapa të rëndësishme në këtë drejtim. Në shumë shoqëri janë duke u kryer investime të rëndësishme për rehabilitimin apo zgjerimin e sistemit të kanalizimeve. Gjithashtu përmirësime të rëndësishme të këtij shërbimi janë bërë nëpërmjet funksionimit e impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura. Aktualisht numri i tyre tani 4 dhe priten të fillojnë nga puna edhe impiante të tjera, impakti i të cilave është i drejtpërdrejtë në mjedis.

Mbrojtja e mjedisit merr një rëndësi të veçantë pasi është e lidhur ngushtë me angazhimet e Shqipërisë për anëtarësimin në BE, prandaj investimet për përmirësimin e këtij shërbimi do të vazhdojnë të rriten. Për këtë arsye kostot e këtij shërbimi do të rriten ndjeshëm, gjë e cila duhet të mbahet parasysh në gjetjen e një ekuilibri sa më të mirë në mbulimin e tyre. Sigurisht një pjesë e konsiderueshme e këtyre shpenzimeve do të mbulohen nga tarifa por mbulimi i kostove totale do të krijojë probleme për konsumatorët. Prandaj është e rëndësishme të gjenden mekanizma subvencionimi për të bërë të mundur mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe njëkohësisht funksionimin e këtyre sistemeve në mënyrë të qëndrueshme.

Perspektiva për të ardhmen

Publikimi i raportit të performancës për vitin 2012 është një hap i rëndësishëm në vendosjen e praktikave rregullatore në vend. Publikimi i përvitshëm i rezultateve të performancës për të gjithë operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura rrit përgjegjësinë e shoqërive për shërbimin që ofrojnë si dhe i nxit ato për përmirësime të mëtejshme në të ardhmen.

Viti 2013 do të jetë një vit tjetër progresi për ERRU në drejtim të një performancë gjithnjë në rritje në ushtrimin e funksionit të tij dhe në zbatimin e mandatit dhe misionit rregullator. ERRU do të vazhdojë të ndërmarrë iniciativa që do të fokusohen në arritjen e objektivave të tij. Rezultatet e vlerësimit të performancës mesazhet dhe konkluzionet e këtij raporti do të ndihmojnë për një vendimmarrje më të drejtë.

ERRU do të vazhdojë të monitorojë performancën e sektorit në tërësi si dhe aspekte të veçanta të këtij shërbimi, rezultatet e të cilave do të bëhen publike dhe do të jenë objekt diskutimi me palët e interesit më qëllim përmirësimin e qëndrueshëm të shërbimeve që ju ofrohen konsumatorëve. Në veçanti do të punohet për të rritur saktësinë e të dhënave. Kontrolli dhe verifikimi i të dhënave të raportuara do të jetë një nga prioritetet e punës së rregullatorit.

Në raportin pasardhës analiza e TKP për çdo operator do të jetë më e gjerë dhe më e detajuar për të evidentuar shkaqet dhe problemet që lidhen me nivelin dhe ecurinë e tyre.

ERRU do të rishikojë treguesit kryesorë të përzgjedhur për vlerësimin e performancës së shoqërive si dhe do të bëjë rivlerësimin e tyre.

Përfshirja e të gjithë aktorëve që veprojnë në sektor: shoqëritë, pushtetet vendore si pronarë të tyre, vendim marrësit politikë dhe këshillat mbikqyrëse në një dialog konstruktiv do të bëjë të mundur që shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri të arrijë standartet e kërkuara.

Aneks: Të dhënat Kryesore të Përzgjedhura

Tabela 11. Të dhënat kryesore të shoqërive për tre grupet

Nr	Aktiviteti	Operatori	Nr i klientëve (ujësjellës)	Nr i klientëve (uji i ndotur)	Nr i punonjësve	Prodhimimi m ³	Faturimi m ³	Totali i faturimit UK (000/lek)	Të ardhura të tjera Leke	Totali i arkëtimit UK (000/lek)	Kosto O&M UK	Kosto Totale UK
Grupi 1	UK	Tiranë	166,829	151,674	1,136	104,712	33,265	2,267,285	261,143	2,482,740	1,477,948	2,191,480
	UK	Durrës	72,112	49,653	567	26,668	8,629	598,624	117,230	486,142	954,792	1,040,496
	U	Vlorë	39,463	-	230	20,279	5,326	231,189	-	166,609	317,812	365,812
	UK	Elber sh.p.k	29,434	7,854	173	14,846	3,443	287,041	9,693	229,862	202,531	360,676
	UK	Fier	27,257	20,690	307	13,688	4,629	258,664	12,425	237,255	318,504	401,215
	UK	Shkodër	26,880	19,443	213	13,699	4,057	246,202	79	145,611	226,792	259,074
	UK	Berat - Kuçovë	24,915	21,217	268	20,753	3,123	161,703	1,971	122,539	150,794	207,109
	UK	Kavajë	22,508	5,925	167	2,846	1,712	77,574	14,667	54,017	93,762	233,860
	UK	Korçë	20,759	19,755	95	3,655	2,533	249,880	19,111	222,116	177,435	308,813
	U	Elbasan Fshat	17,143	-	219	3,334	2,132	118,005	2,596	100,554	168,823	234,259
	UK	Sarandë	14,129	10,776	83	4,538	1,081	71,150	5,287	49,970	79,765	123,681
	UK	Pogradec	13,837	10,233	112	2,014	1,404	101,962	1,513	85,298	79,685	112,939
Grupi 2	UK	Lushnjë	10,541	7,049	131	4,328	1,209	77,832	1,426	73,485	97,187	132,758
	UK	Gjirokastrë	9,188	2,536	96	5,695	1,573	76,172	2,031	63,402	59,024	64,052
	UK	Lezhë	7,089	7,088	81	2,267	1,147	82,074	4,197	67,550	103,833	130,479
	U	Korçë Fshat	5,929	-	51	991	699	13,956	169	12,271	38,234	43,193
	U	Lushnjë Fshat	5,843	-	82	732	476	29,212	-	16,900	38,259	51,723
	U	Kurbin	5,289	-	83	4,490	1,142	40,121	225	16,091	79,120	82,937
	UK	Kukës	4,973	3,434	71	940	709	27,759	178	19,432	38,802	56,647
	U	Patos	4,779	-	122	1,996	1,378	38,269	529	27,408	164,758	173,158
	UK	Librazhd	4,681	4,436	61	717	552	32,476	2,902	29,358	33,749	40,778
	UK	Burrel	4,305	2,705	47	1,715	456	16,495	-	12,444	16,579	25,941
	UK	Rrogozhinë	4,129	1,637	35	352	293	9,934	-	7,595	21,427	28,484
	UK	Mallakastër	4,002	1,471	85	732	454	28,380	731	23,503	64,049	70,312
	U	Gramsh	3,873	-	52	1,020	677	27,138	51	23,741	26,190	33,020
	U	Tepelenë	3,680	-	65	880	456	25,472	-	21,143	33,296	41,828

Aneks: Të dhënat Kryesore të Përzgjedhura

Tabela 11. Të dhënat kryesore të shoqërive për tre grupet

Grupi 2	UK	Krujë	3,554	2,628	38	1,190	461	22,254	406	16,084	21,963	44,310
	U	Peshkopi	3,327	-	39	1,497	703	23,808	446	16,744	18,921	27,752
	U	Përmet	3,236	-	37	532	330	15,678	969	14,371	19,546	22,807
Grupi 3	UK	Himarë	2,807	1,234	34	690	670	24,500	-	7,208	19,297	21,136
	U	Divjakë	2,789	-	38	258	182	9,456	540	10,258	16,440	18,710
	UK	Peqin	2,758	-	51	944	410	26,065	-	10,977	42,948	98,490
	U	Ura Vajgurore	2,703	-	34	982	363	18,682	400	18,202	35,863	39,270
	U	Bulqizë	2,676	-	47	767	483	10,394	129	7,800	19,719	22,250
	U	Delvinë	2,595	1,114	33	412	302	24,667	1,381	17,982	27,131	29,167
	U	Bilisht	2,372	-	23	690	260	12,008	1,141	11,298	20,061	22,011
	U	Novoselë	2,314	-	34	900	445	17,832	408	12,815	34,373	38,621
	U	Shkodër Fshat	2,165	-	79	1,329	649	18,972	120	14,338	50,284	89,320
	UK	Fushë Krujë	2,149	1,764	35	532	241	10,259	411	6,882	20,325	30,575
	U	Orikum	1,875	-	17	411	236	8,382	65	4,376	32,907	34,647
	U	Malësi e Madhe	1,841	-	32	1,020	396	13,850	225	4,795	8,696	10,660
	U	Tropojë	1,769	-	33	1,260	383	14,807	6	4,404	17,765	21,476
	U	Çorovodë	1,760	-	34	547	236	8,679	-	4,809	22,554	35,046
	UK	Ersekë	1,660	1,660	18	586	209	10,121	785	8,986	13,007	15,667
	U	Polican	1,621	-	38	785	234	12,868	35	9,057	29,415	33,185
	UK	Selenicë	1,506	-	13	677	132	5,728	-	4,566	14,206	14,626
	UK	Mirditë	1,204	1,038	27	869	239	15,677	-	9,455	26,736	30,226
	UK	Pukë	1,107	1,094	21	493	155	7,909	-	7,254	9,955	24,601
	U	Has	1,078	-	32	817	215	6,639	-	3,606	20,026	23,890
	U	Kelcyrë	1,002	-	14	740	108	5,258	46	4,353	7,804	9,916
	U	Vau i Dejës	880	-	12	650	177	5,296	-	2,982	13,808	15,680
	UK	Libohovë	783	567	7	212	130	4,065	-	3,159	12,616	14,900
	UK	Fushë Arrëz	540	478	9	456	117	3,306	-	1,864	4,094	14,606
	UK	Pukë Fshat	524	78	19	420	127	2,494	-	1,971	10,542	16,914
	UK	Rubik	498	478	14	163	117	4,842	36	3,565	6,485	7,847
	UK	Krastë	394	341	15	176	95	3,161	-	3,020	6,779	13,490
	U	Gjirokastrë Fshat	302	-	13	396	319	2,049	408	1,790	7,011	9,183

Tabela 12. Tarifet e ujit të pijshëm dhe Kanalizimeve të 57 shoqërive

Nr	Aktiviteti	Operatori	Kosto për m³ të shitur	Tarifat për ujin e pijshëm (lek/m³)			Tarifë shërbimi (lek/tidhje/muaj)	Tarifat për kanalizimet (lek/m³)		
				Familjar	Buxhetor	Privat		Familjar	Buxhetor	Privat
Grupi 1	UK	Tiranë	63.58	45	120	135	100	11	30	35
	UK	Durrës	109.21	58	110	120	100	15	20	20
	U	Vlorë	63.89	30	60	80				
	UK	Elber sh.p.k	103.35	38	115	130		8	25	30
	UK	Fier	80.19	44	80	100	100	10	12	14
	UK	Shkodër	59.97	40	110	110	100	15	20	20
	UK	Berat - Kuçovë	60.91	35	110	110		8	14	16
	UK	Kavajë	103.00	38	80	100		15	20	20
	UK	Korçë	72.90	60	105	140	100	30	50	50
	U	Elbasan Fshat	109.88	36	110	110	100			
	UK	Sarandë	98.22	44	120	120	100	16	25	25
	UK	Pogradec	54.42	55	110	110	40	18	25	25
Grupi 2	UK	Lushnjë	96.46	44	100	110	100	12	16	18
	UK	Gjirokastrë	37.02	34	110	120	50	8	14	14
	UK	Lezhë	99.84	50	115	120	100	12	16	20
	U	Korçë Fshat	61.81							
	U	Lushnjë Fshat	108.62	60	70	100				
	U	Kurbin	72.60	30	80	120	50			
	UK	Kukës	67.50	25	60	80		7	15	20
	U	Patos	125.65							
	UK	Librazhd	60.94	38	100	100		13	22	23
	UK	Burrel	54.56	23	60	80		2	4	6
	UK	Rrogozhinë	85.71	45	80	90		8	10	10
	UK	Mallakastër	152.64							
	U	Gramsh	48.78	32	90	90				
	U	Tepelenë	91.83	33	100	120				
	UK	Krujë	80.51	33	80	80		8	12	12
	U	Peshkopi	39.50	27	65	85				
	U	Përmet	69.09	38	100	120	50			

Grupi 3

Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

